

Projekt-kushtetutë për Dardaninë

Dr. Getoar Mjeku*

Me këtë projekt, jam përpjekë me i sanu të metat e kushtetutës së 2008-ës, duke qartësuar pushtetin e popullit si sovran, duke i zgjëru të drejtat e njeriut, dhe duke e përcaktuar me përpikëri mënyrën si zgjedhen dhe veprojnë ngrahimet e shtetit.

Përveç përmbajtjes së re dhe huazimeve nga kushtetutat botërore, projekti përfshin edhe pjesë të rishkruara të kushtetutave të mëparshme të vendit. Teksti ka afro 13 mijë fjalë, rreth tremijë më pak se kryeligi i 2008-ës, dhe është shkruar me gjuhë të thukët, fjali të shkurta e të kuptueshme, dhe fjalë sa më shqipe.

U jam mirënjohës bashkëqytetarëve Yll Abdyli dhe Dren Shporta që më sugjeruan përmirësime në disa pjesë të tekstit. Gabimet mbeten të miat.

Përmbajtja

Parathënie.....	8
Kreu I. Parime themelore.....	8
Nënkreu A. Shteti.....	8
Neni 1. Përcaktimi.....	8
Neni 2. Sovraniteti popullor.....	8
Neni 3. Qeverisja.....	9
Nënkreu B. Ligjshmëria.....	9
Neni 4. Shteti ligjor.....	9
Neni 5. Epërsia e Kushtetutës.....	9
Neni 6. E drejta ndërshtetërore.....	9
Neni 7. Burimet e ligjvënies.....	9
Nënkreu C. Vetëvetësia shtetërore.....	10
Neni 8. Vetëvetësia evropiane.....	10
Neni 9. Kombi shqiptar.....	10
Neni 10. Gjuhët.....	10
Neni 11. Simbolet.....	10
Neni 12. Kryeqyteti.....	10
Kreu II. Të drejtat themelore.....	11

* Shtetas i Kosovës dhe avokat i licencuar në shtetin e Teksasit, ShBA; postel: GM@Getoar.com

Nënkreu A. Parime të përgjithshme.....	11
Neni 13. Përcaktimi.....	11
Neni 14. Kufizimi i ligjshëm.....	11
Neni 15. Shqyrtimi i kufizimit.....	11
Nënkreu B. Të drejtat vetjake.....	12
Neni 16. Denjësia njerëzore.....	12
Neni 17. E drejta për jetën.....	12
Neni 18. Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar.....	12
Neni 19. Ndalimi i torturës dhe trajtimit jonjerëzor.....	12
Neni 20. Barazia.....	12
Neni 21. E drejta e tërësisë vetjake.....	13
Neni 22. E drejta e privatësisë.....	13
Neni 23. Kontrolli i ligjshëm.....	14
Neni 24. Miratimi i kontrollit.....	14
Neni 25. E drejta e besës.....	14
Neni 26. E drejta e lirisë.....	15
Neni 27. Ndalja e ligjshme.....	15
Neni 28. Masat para gjykimit.....	15
Neni 29. Mjetet për mbrojtjen e lirisë.....	16
Nënkreu C. Ecuria e drejtë ligjore.....	16
Neni 30. Gjykimi i ndershëm.....	16
Neni 31. E drejta e mbrojtjes.....	16
Neni 32. Ndalimi i dëshmive të paligjshme.....	17
Neni 33. Pandehja e pafajësisë.....	17
Neni 34. Ndalimi i stërgjykimit.....	17
Neni 35. Ndalimi i ndëshkimit të padrejtë.....	17
Neni 36. Qasja në drejtësi.....	18
Neni 37. Ndihma juridike.....	18
Neni 38. Të drejtat e viktimës.....	18
Nënkreu Ç. Të drejtat mbi truallin.....	18
Neni 39. Shtetësia.....	18
Neni 40. Mbrojtja e qytetarëve.....	19
Neni 41. E drejta e lëvizjes.....	19
Neni 42. Të huajt.....	19
Nënkreu D. Liritë qytetare.....	20
Neni 43. Liria shpirtërore.....	20
Neni 44. Bashkësitë fetare.....	20
Neni 45. Liria e shprehjes dhe njoftimit.....	20
Neni 46. Liria e medieeve.....	20
Neni 47. Liria e tubimit dhe shoqërimit.....	21
Nënkreu Dh. Të drejtat e demokracisë.....	21
Neni 48. Të drejtat zgjedhore.....	21

Neni 49. Barazia gjinore.....	21
Neni 50. Veprimi qytetar.....	21
Neni 51. Mbrojtja e demokracisë.....	22
Nënkreu E. Familja.....	22
Neni 52. Mbrojtja e familjes.....	22
Neni 53. Martesa.....	22
Neni 54. Fëmijët.....	23
Neni 55. Prindërit.....	23
Nënkreu Ë. Jetesa e ndershme.....	23
Neni 56. Liria e zhvillimit.....	23
Neni 57. E drejta e pronës.....	23
Neni 58. E drejta e plangut.....	24
Neni 59. E drejta e punës.....	25
Neni 60. E drejta për grevë.....	25
Neni 61. Mbrojtja shoqërore.....	25
Neni 62. E drejta e arsimimit.....	26
Neni 63. Mjedisi jetësor.....	26
Neni 64. Të drejtat teknologjike.....	26
Nënkreu F. Të drejtat e kombësive.....	26
Neni 65. Përcaktimi.....	26
Neni 66. Roli i shtetit.....	27
Neni 67. Të drejtat simbolike dhe gjuhësore.....	27
Neni 68. Të drejtat arsimore.....	27
Neni 69. Përfaqësimi dhe punësimi.....	28
KREU III. PRIJETARI.....	28
Nënkreu A. Përcaktimi dhe tagri.....	28
Neni 70. Përcaktimi.....	28
Neni 71. Tagri.....	28
Nënkreu B. Zgjedhja.....	29
Neni 72. Përcaktimi.....	29
Neni 73. Cilësimi.....	29
Neni 74. Votimi i parë.....	29
Neni 75. Dytësimi.....	29
Nënkreu C. Mandati.....	30
Neni 76. Fillimi dhe afati.....	30
Neni 77. Zbrazëtia.....	30
Neni 78. Papajtueshmëria.....	30
Neni 79. Shlirime.....	30
Nënkreu Ç. Mungesa dhe shkarkimi.....	31
Neni 80. Ushtrues-detyre Prijetari.....	31
Neni 81. Shkarkimi.....	31
Neni 82. Ecuria e shkarkimit.....	31

KREU IV. KUVENDI.....	32
Nënkreu A. Përcaktimi dhe tagri.....	32
Neni 83. Përcaktimi.....	32
Neni 84. Tagri.....	32
Nënkreu B. Zgjedhja.....	32
Neni 85. Përcaktimi.....	32
Neni 86. Cilësimi.....	32
Neni 87. Viset zgjedhore.....	33
Nënkreu C. Mandati.....	33
Neni 88. Përcaktimi.....	33
Neni 89. Afati.....	33
Neni 90. Mbarimi i parakohshëm.....	33
Neni 91. Papajtueshmëria.....	34
Neni 92. Shlirime.....	34
Nënkreu Ç. Rregullimi i brendshëm.....	34
Neni 93. Rregullorja e punës.....	34
Neni 94. Kryesia.....	34
Neni 95. Mbledhjet.....	35
Neni 96. Orari.....	35
Neni 97. Punimet.....	35
Neni 98. Komisionet.....	35
Nënkreu D. Ecuria ligjvënëse.....	35
Neni 99. Nisma ligjvënëse.....	35
Neni 100. Miratimi.....	35
Neni 101. Shpallja.....	36
Neni 102. Hyrja në fuqi.....	36
Nënkreu Dh. Vendime të posaçme.....	36
Neni 103. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.....	36
Neni 104. Kushtetutshmëria e marrëveshjeve ndërkombëtare.....	37
Neni 105. Ligje të posaçme.....	37
Neni 106. Kërkesa për shpërndarje.....	38
KREU V. KABINETI.....	38
Nënkreu A. Përcaktimi dhe tagri.....	38
Neni 107. Përcaktimi.....	38
Neni 108. Tagri i Kabinetit.....	38
Neni 109. Tagri i Kryeministrit.....	38
Nënkreu B. Zgjedhja.....	39
Neni 110. Mandatimi nga Prijetari.....	39
Neni 111. Miratimi në Kuvend.....	39
Neni 112. Përmbysja e mandatarit.....	39
Neni 113. Mandatimi nga Kuvendi.....	40
Neni 114. Ribërja e Kabinetit.....	40

Neni 115. Dorëheqja e Kabinetit.....	40
Nënkreu C. Puna.....	40
Neni 116. Përgjegjësia.....	40
Neni 117. Shlirime.....	41
Neni 118. Rregullimi i brendshëm.....	41
KREU VI. GJYQËSIA.....	41
Nënkreu A. Parime të përgjithshme.....	41
Neni 119. Përcaktimi.....	41
Neni 120. Kushtetutshmëria.....	41
Neni 121. Lëndët gjyqësore.....	42
Neni 122. Pagjykseshmëria.....	42
Nënkreu B. Gjykatat.....	42
Neni 123. Gjykatat themelore dhe ankimore.....	42
Neni 124. Gjykata e Naltë.....	42
Neni 125. Rregullimi.....	43
Nënkreu C. Gjyqtarët.....	43
Neni 126. Mandati.....	43
Neni 127. Pavarësia dhe papajtueshmëria.....	43
Neni 128. Shlirime.....	43
Neni 129. Bartja.....	44
Neni 130. Shkarkimi.....	44
Nënkreu Ç. Këshilli gjyqësor.....	44
Neni 131. Përcaktimi dhe tagri.....	44
Neni 132. Përbërja.....	44
Neni 133. Puna.....	45
KREU VII. GJYKATA KUSHTETUTORE.....	45
Nënkreu A. Përcaktimi dhe tagri.....	45
Neni 134. Përcaktimi.....	45
Neni 135. Tagri.....	45
Nënkreu B. Gjyqtarët kushtetutorë.....	46
Neni 136. Emërimi.....	46
Neni 137. Emërimi.....	46
Neni 138. Pavarësia dhe papajtueshmëria.....	47
Neni 139. Shlirime.....	47
Neni 140. Shkarkimi.....	48
Nënkreu C. Puna.....	48
Neni 141. Rregullimi i brendshëm.....	48
Neni 142. Shqyrtimi i lëndëve.....	48
Neni 143. Fuqia juridike.....	49
Neni 144. Vendime të posaçme.....	49
KREU VIII. ORGANE TË POSAÇME.....	49

Nënkreu A. Përndjekësit shtetërorë.....	49
Neni 145. Përcaktimi.....	49
Neni 146. Mandati.....	49
Neni 147. Pavarësia dhe papajtueshmëria.....	50
Neni 148. Kryepërndjekësi.....	50
Neni 149. Këshilli Përndjekësor.....	50
Nënkreu B. Avokati i Popullit.....	50
Neni 150. Përcaktimi dhe tagri.....	50
Neni 151. Emërimi.....	51
Neni 152. Zëvendësi.....	51
Neni 153. Puna.....	51
Neni 154. Papajtueshmëria.....	52
Neni 155. Shlirime.....	52
Neni 156. Shkarkimi.....	52
Nënkreu C. Rishikuesi i Përgjithshëm.....	52
Neni 157. Përcaktimi dhe tagri.....	52
Neni 158. Raportimet.....	53
Neni 159. Emërimi dhe mandati.....	53
Neni 160. Shkarkimi.....	53
Nënkreu Ç. Organe tjera.....	53
Neni 161. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.....	53
Neni 162. Banka e Dardanisë.....	54
Neni 163. Komisioni i Medieve.....	54
Neni 164. Agjencitë e pavarura.....	54
Neni 165. Papajtueshmëria.....	54
KREU IX. MBROJTJA DHE RENDI.....	55
Nënkreu A. Parime të përgjithshme.....	55
Neni 166. Përcaktimi.....	55
Neni 167. Detyrat e qytetarëve.....	55
Neni 168. Të drejtat e shërbyesve.....	55
Nënkreu B. Organet.....	55
Neni 169. Ushtria.....	55
Neni 170. Këshilli i Mbrojtjes.....	56
Neni 171. Policia.....	56
Neni 172. Zbulimi.....	56
Nënkreu C. Masat e jashtëzakonshme.....	57
Neni 173. Përcaktimi.....	57
Neni 174. Ligjshmëria.....	57
Neni 175. Gjendja e luftës.....	57
Neni 176. Gjendja e jashtëzakonshme.....	58
Neni 177. Gjendja e fatkeqësisë.....	58
Neni 178. Kufizimi i të drejtave.....	58

Neni 179. Pushteti ligjvënës.....	59
KREU X. SHQITJE TJERA.....	59
Nënkreu A. Çështje ekonomike.....	59
Neni 180. Rendi ekonomik.....	59
Neni 181. Financat.....	60
Neni 182. Të mirat e veçanta.....	60
Neni 183. Privatizimi.....	60
Nënkreu B. Çështje kombëtare.....	60
Neni 184. Logu Kombëtar.....	60
Neni 185. Këshilli i Kombësive.....	61
Nënkreu C. Pushteti vendor dhe ndarja tokësore.....	61
Neni 186. Përcaktimi.....	61
Neni 187. Bashkitë.....	61
Neni 188. Trevat.....	61
Neni 189. Organet qendrore.....	62
Nënkreu Ç. Parime shtesë të qeverisjes.....	62
Neni 190. Orari i zgjedhjeve.....	62
Neni 191. Ecuria zgjedhore.....	62
Neni 192. Formula e betimit.....	62
Neni 193. Rroga e zyrtarëve.....	63
Nënkreu D. Referendumi.....	63
Neni 194. Kërkesa dhe shpallja.....	63
Neni 195. Rishikimi gjyqësor.....	63
Neni 196. Zhvillimi i referendumit.....	64
Neni 197. Shpallja.....	64
Neni 198. Kufizime.....	64
Nënkreu Dh. Ndryshimi i Kushtetutës.....	64
Neni 199. Nisma dhe miratimi.....	64
Neni 200. Rishikimi gjyqësor.....	65
Neni 201. Rimiratimi.....	65
Neni 202. Shpallja.....	65
Nënkreu E. Kalimtare dhe të fundit.....	65
Neni 203. Emërtimi i vendit.....	65
Neni 204. Ligjshmëria.....	66
Neni 205. Hyrja në fuqi.....	66

Parathënie

Ne, populli i Dardanisë së lirë e të pavarur, —

lidhë besa-besë për me mbrojtë jetën, denjësinë, e lirinë e secilit njeri, pa dallim; për me i rujtë doket, gjuhën, dhe vetëvetësinë tonë kombëtare; dhe për me jetësu vegimin e të parëve tanë për dheun stërgjyshor dhe ëndrrat e të gjithë brezave që vijnë, duke ndërtu një shtet të drejtë, përparimtar, e të fuqishëm, që do të rrojë me nder në gjirin e kombeve paqedashëse të Evropës së bashkuar; tash e sa të ketë mot —

shpallim e vendojmë këtë Kushtetutë.

Kreu I. Parime themelore

Nënkreu A. Shteti

Neni 1. Përcaktimi

- 1.1 Dardania është vend i lirë dhe shtet i pavarur, sovran, dhe i njëshëm, me tërësi tokësore të pacenueshme dhe të patjetërsueshme.
- 1.2 Shteti dardan është republikë demokratike, shoqërore, dhe shekullare. Shteti dhe republika janë themelu nga populli për t'i mbrojtë të drejtat themelore dhe për të vepru vetëm për të mirën e popullit.
- 1.3 Popullin e përbëjnë kombi shqiptar si dhe kombësitë dhe qytetarët dardanë pa dallim.

Neni 2. Sovraniteti popullor

- 2.1 Shteti dhe sovraniteti i përkasin përherë popullit. Populli e ushtron sovranitetin vetëm në mënyrat që i parasheh vetë me Kushtetutë.
- 2.2 Populli lidh besën se do t'i mbrojtë përjetësisht dhe me të gjitha mjetet Dardaninë, sovranitetin e popullit, dhe të drejtat themelore. Për aq kohë sa e mban besën e dhënë, populli mund t'i bëjë Kushtetutës çfarëdo ndryshimi që e sheh të vryeshëm.

Neni 3. Qeverisja

- 3.1 Populli përligj organet shtetërore përmes zgjedhjeve të lira e të periudhshme.
- 3.2 Organet shtetërore veprojnë duke u mbështetë në ndarjen dhe baraspe-shimin e pushteteve ligjvënës, përmbarrimor, gjyqësor, dhe të posaçëm.

Nënkreu B. Ligjshmëria

Neni 4. Shteti ligjor

- 4.1 Çdo njeri dhe vetë juridike i nënshtrohet Kushtetutës dhe ligjeve tjera.
- 4.2 Kushtetuta dhe rendi ligjor nuk mund të pezullohen në asnjë rrethanë.

Neni 5. Epërsia e Kushtetutës

- 5.1 Kushtetuta është ligji më i lartë i vendit. Të gjitha ligjet duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën.
- 5.2 Kushtetuta nuk mund të ndryshohet ose shfuqizohet, përveçse në mënyrën e përcaktuar me Kushtetutë.

Neni 6. E drejta ndërshtetërore

- 6.1 Dardania zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme. Marrëveshjet ndërshtetërore të ratifikuara janë ligj i vendit dhe marrin përparësi ndaj ligjeve tjera, me përjashtim të Kushtetutës.
- 6.2 Aktet ligjore e nënligjore të një organizate mbarëkombëtare, sipërkombëtare, ose ndërkombëtare mund të marrin përparësi ndaj ligjeve vendase, me përjashtim të Kushtetutës.

Neni 7. Burimet e ligjvënies

- 7.1 Kushtetuta, e drejta ndërshtetërore, e drejta dokesore shqiptare, e drejta bashkënore evropiane (*Acquis communautaire*), dhe vullneti i popullit janë burimet e vetme të ligjvënies.
- 7.2 Traditat dhe librat fetarë nuk mund të jenë burim i ligjvënies ose ligjit.

Nënkreu C. Vetëvetësia shtetërore

Neni 8. Vetëvetësia evropiane

- 8.1 Dardania është pjesë historike dhe kulturore e bashkësisë së kombeve të Evropës.
- 8.2 Shteti nxit bashkëpunimin mes vendeve të Evropës në të mirë të paqes, demokracisë, drejtësisë, dhe përparimit ekonomik të qytetarëve evropianë.

Neni 9. Kombi shqiptar

- 9.1 Dardania është pjesë e pandashme e kombit shqiptar.
- 9.2 Shteti nxit bashkëpunimin mbarëkombëtar dhe mbron interesat e shqiptarëve jashtë Dardanisë.

Neni 10. Gjuhët

- 10.1 Shqipja është gjuha zyrtare e shtetërore, dhe ka përparësi ndaj gjuhëve tjera.
- 10.2 Organet shtetërore mund ta përdorin, sipas nevojave të qytetarëve, cilëndo gjuhë trashëgimisht të folur në Dardani. Këto gjuhë përfshijnë gjuhët shqiptare dhe dardane të shenjave, sërbihten, turqishten, boshnjakishten, romishten, malazesishten, dhe çerkezishten.
- 10.3 Organet shtetërore mund të përdorin një gjuhë të huaj vetëm në marrëdhënie ndërkombëtare ose sipërkombëtare ose kur e kërkon ndarja e drejtësisë.

Neni 11. Simbolet

- 11.1 Organet shtetërore dhe qytetarët mund të përdorin, sipas ligjit, flamurin kombëtar shqiptar, flamurin shtetëror, dhe simbole tjera për ta përfaqësuar Dardaniën.
- 11.2 Flamuri shtetëror ngërthen një shfaqësime të flamurit kombëtar të stolitur me shenja dalluese të trashëgimisë dardane.

Neni 12. Kryeqyteti

- 12.1 Kryeqyteti i Dardanisë dhe selia e organeve qendrore është Prishtina.

12.2 Selia e organeve mbarëkombëtare është Prizreni.

Kreu II. Të drejtat themelore

Nënkreu A. Parime të përgjithshme

Neni 13. Përcaktimi

- 13.1 Të drejtat themelore janë të gjithësishtme, të pandashme, të pacenueshme, dhe të patjetërsueshme, dhe përbëjnë themelin e rendit ligjor.
- 13.2 Të drejtat themelore vlejné, për aq sa janë të zbatueshme, për të gjithë njerëzit dhe vetat juridike. Por të drejtat themelore i takojné një vete juridike për aq sa mbrojtja e tyre është e domosdoshme për veprimtarinë e ligjshme që ushtron veta.
- 13.3 Çdonjëri ka detyrë t'i respektojé të drejtat themelore.

Neni 14. Kufizimi i ligjshëm

- 14.1 Ndalohet çdo përpjekje me shkelé një të drejté themelore.
- 14.2 Një e drejté themelore nuk mund të kufizohet pos me ligj dhe vetém për aq sa kufizimi është i domosdoshëm për të mbrojté vendin, rendin kushtetutor, ose të drejtat e të tjerëve.
- 14.3 Kufizimi i një të drejte themelore nuk mund ta mohojé thelbin e saj ose të tejkalojé kufizimet e lejuara nga mjetet mbarevropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Neni 15. Shqyrtimi i kufizimit

Kur kufizohet një e drejté themelore, organet shtetërore shqyrtojnë mundësiné me arritë qëllimin me kufizim më të vogël, duke i kushtu vëmendje:

- (1) thelbit të së drejtës që kufizohet;
- (2) rëndësisé së qëllimit të kufizimit;
- (3) natyrës dhe vëllimit të kufizimit; dhe
- (4) përputhjes midis kufizimit dhe qëllimit të kufizimit.

Nënkreu B. Të drejtat vetjake

Neni 16. Denjësia njerëzore

Denjësia e njeriut është e pacenueshme.

Neni 17. E drejta për jetën

17.1 Çdonjëri ka të drejtë me jetu.

17.2 Jeta fillon që në ngjizje.

17.3 Askujt nuk mund t'i merret jeta për gjakmarrje ose për përmbarrimin e një dënimi me vdekje.

Neni 18. Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar

18.1 Askush nuk mund të mbahet në skllavëri ose robëri.

18.2 Askush nuk mund të shtrëngohet me bë punë të detyruar. Nuk quhet punë e detyruar:

- (1) puna ose shërbimi i përcaktuar me ligj për të dënuarit me vendim të prerë;
- (2) shërbimi në Ushtri ose shërbimi për mbrojtjen e vendit; ose
- (3) shërbimi i përcaktuar me ligj për rastet e masave të jashtëzakonshme.

Neni 19. Ndalimi i torturës dhe trajtimit jonjerëzor

19.1 Askush nuk mund t'i nënshtrohet:

- (1) shitjes ose trafikimit;
- (2) rrahjes ose torturës; ose
- (3) trajtimit a ndëshkimit mizor, çnjerëzor, poshtërues, a gjymtues.

Neni 20. Barazia

20.1 Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe gëzojnë mbrojtje të barabartë ligjore.

20.2 Ndalohet trajtimi i pabarabartë ose nxitja e mosdurimit për shkaqe të:

- (1) gjinisë, seksit, ose kahjes seksore;
- (2) racës, ngjyrës, kombësisë, prejardhjes, gjuhës, ose të folmes;
- (3) fesë ose bindjeve shpirtërore;
- (4) fisit, derës, familjes, pronës, ose gjendjes amvisnore a shoqërore;
- (5) trevës, vendbanimit, ose mërgimit a arsimimit jashtë vendit;
- (6) mendimit ose shoqërimit;
- (7) amësisë a atësisë, lindjes, ose parbinisë;
- (8) dukjes, moshës, sëmundjes, ose aftësisë së kufizuar; ose
- (9) ndonjë gjendjeje tjetër.

20.3 Shteti mbron ata që janë në gjendje të pabarabartë dhe u ndihmon përderisa përpiqen të përparojnë aq sa munden me përparu. Por veprimet shtetërore duhet:

- (1) të mos krijojnë mbresë të rreme ose sapërsyefaqe të barazisë;
- (2) të mos shkaktojnë varshmëri nga ndihma shtetërore; dhe
- (3) të mos pengojnë shtytjet për përpjekje individuale ose shoqërore.

Neni 21. E drejta e tërësisë vetjake

Çdonjëri ka të drejtën e tërësisë trupore dhe mendore. Kjo e drejtë përfshin të drejtën:

- (1) me marrë, sipas ligjit, vendime lidhur me shtimin;
- (2) me pasë kontroll mbi trupin e vet;
- (3) mos me iu nënshtru trajtimit mjekësor kundër vullnetit të vet; dhe
- (4) mos me marrë pjesë, pa dhënë pëlqimin e vet paraprak, në prova mjekësore ose shkencore.

Neni 22. E drejta e privatësisë

22.1 Çdonjëri ka të drejtën e privatësisë. Kjo e drejtë përfshin të drejtën e:

- (1) respektit për hapësirën vetjake dhe jetën private e familjare;
- (2) pacenueshmërisë së banesës dhe objekteve private; dhe

(3) fshehtësisë e kumtimit privat dhe të të dhënave vetjake.

22.2 E drejta e privatësisë ngërthen lirinë nga kontrolli, përfshi kontrollin natyror, marrjen e sendeve, dhe vëzhgimin teknologjik.

Neni 23. Kontrolli i ligjshëm

23.1 Asnjë hapësirë vetjake, banesë, objekt privat, ose kumtim nuk mund të kontrollohet, përveçse për aq sa lejohet me miratim gjyqësor ose për aq sa kontrolli është i domosdoshëm:

- (1) për ta ndalë dikë ligjshëm;
- (2) për të mbledhë prova që ka rrezik të humbin; ose
- (3) për ta mënjanu rrezikimin e drejtpërdrejtë dhe të rëndë ndaj njerëzve ose pronës.

23.2 Të dhënat vetjake të njërit nuk mund të vëzhgohen e ruhen rregullisht dhe vetvetiu, përveçse për aq sa lejohet me miratim gjyqësor ose për aq sa vëzhgimi është i domosdoshëm:

- (1) për t'i zbatu marrëveshjet që ka lidhë njeriu të dhënat e të cilit ruhen;
- (2) për t'i përcaktu detyrimet financiare ndaj shtetit; ose
- (3) për të zbatu akte ligjore e nënligjore ndaj veprimtarive ekonomike.

Neni 24. Miratimi i kontrollit

24.1 Gjykata miraton kontrollin paraprakisht, me shkrim, dhe vetëm për aq sa kontrolli është i domosdoshëm për hetimin e një shkeljeje të ndëshkueshme. Gjykata përshkruan saktësisht vendin ose njeriun që do të kontrollohet, sendin që do të merret, dhe të dhënat që do të ruhen.

24.2 Në rast se kontrolli është kry pa miratim gjyqësor, gjykata vlerëson nëse kontrolli ka qenë në pajtim me Kushtetutën. Nëse vlerëson se po, gjykata e miraton kontrollin prapaveprimisht.

Neni 25. E drejta e besës

25.1 Shteti është përgjegjës për sigurinë botore.

- 25.2 Çdonjëri ka të drejtën e besës se askush përpos shtetit nuk do ta përndjekë për kryerjen e një shkeljeje të ndëshkueshme.
- 25.3 Shteti dënon dhe mund t'i shpronësojë ata që shkelin të drejtën e besës.

Neni 26. E drejta e lirisë

- 26.1 Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse sipas ecurisë ligjore, nën dyshimin e arsyeshëm se ka krye një shkelje të ndëshkueshme ose kur dënohet me vendim të prerë gjyqësor.
- 26.2 Organi përgjegjës mund të mbajë një të mitur nën mbikëqyrje edukuese ose kujdestari për t'ia mundësu shoqërimin a kujdesin e nevojshëm.
- 26.3 Organi përgjegjës mund të mbajë nën mbikëqyrje shëndetësore një njeri që për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë.
- 26.4 Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të lajë borxh ose të përmbushë një detyrim kontrate.

Neni 27. Ndalja e ligjshme

- 27.1 Çdonjërit që i hiqet liria njoftohet menjëherë, në një gjuhë që e kupton:
- (1) pse po i hiqet liria dhe për ngarkesat ndaj tij;
 - (2) se nuk është i detyruar me dhënë deklaratë; dhe
 - (3) se ka të drejtë të kumtojë me një mbrojtës, që e zgjedh vetë ose ia caktojnë, dhe me më të afërmit.
- 27.2 Çdonjëri që ngarkohet me shkelje të ndëshkueshme njoftohet me kohë, në një gjuhë që e kupton dhe në hollësi, rreth natyrës dhe shkakut të ngarkesave që i bëhen dhe për të drejtat e të ngarkuarit.

Neni 28. Masat para gjyqimit

- 28.1 Çdonjëri që i hiqet liria pa urdhër gjyqësor duhet të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjyqimit. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e një dorëzanie pasurore.
- 28.2 Askush nuk mund të mbahet në paraburgim në pritje të gjyqimit, përveçse nën vlerësimin e mbështetur se i mbajturi përbën rrezik për rrethin ose se ka rrezik se i mbajturi nuk do të paraqitet në gjykim.

- 28.3 Çdonjëri që i hiqet liria pa urdhër gjyqësor sillet, brenda 48 orëve dhe pa vonesë të paarsyeshme, para një gjyqtari. Brenda 48 orëve vijuese, gjyqtari merr vendim me shkrim dhe të arsyetuar me liru ose me paraburgu të mbajturin.
- 28.4 I paraburguari ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit.

Neni 29. Mjetet për mbrojtjen e lirisë

- 29.1 Çdonjëri ka të drejtë t'i kërkojë një gjyqtari me vlerësu ligjshmërinë e heqjes së lirisë së kujtdo. Gjyqtari përmbush kërkesën brenda 48 orëve dhe, nëse vlerëson se heqja e lirisë është e jashtëligjshme, urdhëron me liru të mbajturin.
- 29.2 Çdonjërit që i hiqet liria në kundërshtim me shqitjet e këtij nënkreu i takon dëmshpërblimi.
- 29.3 Çdonjëri ka të drejtë që, sipas ligjit, të ankohet për kushtet e heqjes së lirisë së kujtdo.

Nënkreu C. Ecuria e drejtë ligjore

Neni 30. Gjykimi i ndershëm

- 30.1 Çdonjëri ka të drejtën e gjykimit të ndershëm, në përcaktimin e të drejtave e detyrimeve qytetnore dhe përgjegjësisë për shkelje të ndëshkueshme. Kjo e drejtë përfshin shqyrtimin e hapur, të drejtë, dhe të paanshëm, brenda një afati të arsyeshem, nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, dhe e themeluar me ligj.
- 30.2 Çdonjëri ka hak qasjen në të gjitha të dhënat zyrtare që janë të domosdoshme për të mbrojtë ose gëzu një të drejtë të veten.
- 30.3 Aktgjykimi jepet i arsyetuar dhe shpallet botërisht.

Neni 31. E drejta e mbrojtjes

- 31.1 Askush nuk mund të gjykohet për një shkelje të ndëshkueshme pa pasë kohë e mjete të mjaftueshme me përgatitë mbrojtjen.
- 31.2 Çdonjëri që ngarkohet me shkelje të ndëshkueshme ka gjithashtu:

- (1) hak çdo provë ose të dhënë që ndodhet në zotërim të shtetit dhe dëshmon ose mbështet pafajësinë e të ngarkuarit, shfaqëson të ngarkuarin, ose ndihmon me lehtësu dënimin;
- (2) hak ndihmën e vyeshme të mbrojtësit dhe të drejtë të kumtojë lirisht e privatisht me mbrojtësin;
- (3) të drejtë të mbrohet, vetë ose përmes mbrojtësit;
- (4) të drejtë që, vetë ose përmes mbrojtësit, t'i marrë në pyetje dhe provë dëshmitarët; dhe
- (5) të drejtë të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve dhe të atyre që mund të sqarojnë faktet.

31.3 Të ngarkuarit që nuk e njeh ose flet gjuhën e ecurisë i mundësohet falas ndihma e përkthyesit.

Neni 32. Ndalimi i dëshmive të paligjshme

Askush nuk mund:

- (1) të shpallet fajtor sipas të dhënave të mbledhura paligjshëm;
- (2) të shtrëngohet me dëshmu kundër vetvetes ose më të afërmve;
- (3) të shtrëngohet me pranë fajësinë; ose
- (4) të detyrohet me dëshmu pafajësinë.

Neni 33. Pandehja e pafajësisë

Çdonjëri që ngarkohet me shkelje të ndëshkueshme merret për i pafajshëm deri kur të dëshmohet fajtor sipas ligjit.

Neni 34. Ndalimi i stërgjyimit

Askush nuk mund të gjykohet ose ndëshkohet dy herë nën tagrin e Dardanisë për të njëjtën shkelje, përveç kur një gjykatë më e lartë urdhëron rigjykimin e çështjes.

Neni 35. Ndalimi i ndëshkimit të padrejtë

35.1 Askush nuk mund të shpallet fajtor ose të ndëshkohet për shkak të një veprimi ose mosveprimi që, në kohën kur u krye, nuk përbënte shkelje të

ndëshkueshme me ligj. As të ndëshkohet me dënim më të rëndë se ç'parashihej në kohën kur u krye shkelja ose se ç'parashihet në kohën e dënimit.

- 35.2 Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në shpërpjesëtim me rëndesën e shkeljes.

Neni 36. Qasja në drejtësi

- 36.1 Çdonjëri ka të drejtë të kërkojë para gjykatës zhdëmtim të efektshëm kur i cenohet një e drejtë ligjore.
- 36.2 Çdonjëri ka të drejtë të ankohet ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj përcaktohet ndryshe.

Neni 37. Ndhimja juridike

- 37.1 Mbrojtësi dhe ndihma juridike i mundësohen falas çdonjërit që nuk ka mjete të mjaftueshme me pagu, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për qasje të efektshme në drejtësi.
- 37.2 Mbrojtësit dhe ndihmësit juridikë janë profesionistë që përmbushin kushtet e përcaktuara me ligj dhe kryejnë shërbime pavarurazi sipas ligjit.

Neni 38. Të drejtat e viktimës

- 38.1 Çdonjëri që, sipas ligjit, është viktimë e një shkeljeje të ndëshkueshme ka të drejtë:
- (1) me qenë i mbrojtur përmes masave të duhura ndaj të ngarkuarit;
 - (2) me u njoftu rreth rastit dhe për ikjen ose lirimit e të ngarkuarit;
 - (3) me marrë pjesë në ecurinë ligjore ndaj të ngarkuarit; dhe
 - (4) me kërku dëmshpërblim nga i ngarkuari.

Nënkreu Ç. Të drejtat mbi truallin

Neni 39. Shtetësia

- 39.1 Çdonjëri i lindur në Dardani ose që ka prind a gjysh dardan është vetvetiu qytetar dardan.

- 39.2 Qytetar dardan mund të bëhet çdonjëri që përmbush kushtet e përcaktuara me ligj dhe, sipas aftësive të veta, njih kënaqshëm gjuhën shtetërore.
- 39.3 Asnjë qytetari nuk mund t'i mohohet ose t'i hiqet e drejta e shtetësisë.
- 39.4 Qytetari dardan ka të drejtë të mbajë njëkohësisht shtetësinë e një shteti tjetër. Por ka detyrë ta bëjë të ditur shtetësinë e huaj sa herë që kandidohet për t'u zgjedhë ose emëru në detyrë zyrtare.

Neni 40. Mbrojtja e qytetarëve

- 40.1 Asnjë qytetar nuk mund të pengohet me hy në Dardani ose të dëbohet a t'i dorëzohet, kundër vullnetit të tij, një shteti të huaj.
- 40.2 Shteti mbron me ligj interesat e qytetarëve jashtë vendit.

Neni 41. E drejta e lëvizjes

- 41.1 Qytetarët dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Dardanisë kanë të drejtë të lëvizin lirisht brenda Dardanisë dhe të zgjedhin vendbanimin.
- 41.2 Çdonjëri ka të drejtë të largohet nga Dardania.

Neni 42. Të huajt

- 42.1 Kanë të drejtën e ndorjes në Dardani të huajt të cilët, në vendet e prejardhjes, rrezikohen nga përndjekja për shkak të gjinisë, racës, fesë, kombësisë, mendimit politik, ose bashkësisë shoqërore.
- 42.2 Një i huaj nuk mund t'i dorëzohet, kundër vullnetit të tij, një shteti tjetër, nëse i huaji rrezikon:
- (1) të ndëshkohet për një vepër ose mosvepër që nuk përbën shkelje të ndëshkueshme sipas ligjeve të Dardanisë;
 - (2) të vuajë dënim më të rëndë nga ç'parashohin ligjet e Dardanisë; ose
 - (3) t'i nënshtrohet një ecurie ligjore ose dënimi që është në kundërshtim me të drejtat themelore të mbrojtura me këtë Kushtetutë.
- 42.3 Me ligj rregullohet e drejta e të huajve me hy dhe qëndru në Dardani.

Nënkreu D. Liritë qytetare

Neni 43. Liria shpirtërore

- 43.1 Çdonjëri ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes, besimit, dhe fesë. Çdonjëri ka të drejtë me pranë, shfaqë, fshehtë, ose ndryshu bindjet, besimin, ose fenë.
- 43.2 Ndalohet çdo përpjekje me ushtru autoritet politik ose gjyqësor në emër të fesë.

Neni 44. Bashkësitë fetare

- 44.1 Shteti mbron vetëqeverisjen e bashkësive fetare dhe monumentet fetare.
- 44.2 Bashkësitë fetare janë të lira që të rregullojnë pavarësisht organizimin e vet të brendshëm dhe veprimtaritë fetare, përfshi ritet.
- 44.3 Bashkësitë fetare kanë të drejtë të themelojnë shkolla fetare dhe ngrehime bamirëse.

Neni 45. Liria e shprehjes dhe njoftimit

- 45.1 Çdonjëri ka të drejtën e lirisë së shprehjes, njoftimit, botimit, dhe kumtimit.
- 45.2 Çdonjëri ka të drejtë të korrigjojë botimin e pasaktë që ia cenon të drejtat a interesat.
- 45.3 Çdonjëri ka të drejtë t'i qasë dokumentet që mbajnë organet shtetërore dhe ngrehimet botore.

Neni 46. Liria e medieve

- 46.1 Mbrohet liria dhe shumësia e medieve.
- 46.2 Çdonjëri ka të drejtë të regjistrojë herëpashere dukuri siç janë pamjet dhe zëri në hapësira botore kur ato janë të hapura për publikun si dhe t'i botojë regjistrimet.
- 46.3 Censura është e ndaluar.
- 46.4 Mediet botore janë profesioniste, të pavarura, dhe të paanshme, dhe rregullohen me ligj. Ato mund të përfitojnë nga buxheti shtetëror vetëm për aq sa veprojnë në pajtim me këtë nen.

Neni 47. Liria e tubimit dhe shoqërimit

- 47.1 Çdonjëri ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të shoqërimit me tjerët. Kjo e drejtë përfshin të drejtën me themelun një shoqatë pa pasë nevojë me siguru leje, me qenë ose jo anëtar i një shoqate, dhe me marrë pjesë në veprimtaritë e një shoqate.
- 47.2 Punonjësit kanë të drejtë të organizohen në sindikata për t'i mbrojtë interesat vetjake. Kjo e drejtë mund të kufizohet me ligj për kategori të veçanta punonjësish për aq sa kufizimi është i domosdoshëm për t'i siguru shoqërisë shërbimet e domosdoshme.

Nënkreu Dh. Të drejtat e demokracisë**Neni 48. Të drejtat zgjedhore**

- 48.1 Çdo qytetar që ka mbushë moshën 18-vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka detyrë me hedhë votën e vet dhe të drejtë të zgjedhë ose të zgjedhet përfaqësues, përveçse kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor ose Kushtetuta përcakton ndryshe.
- 48.2 Vota është vetjake, e barabartë, e lirë, dhe e fshehtë.

Neni 49. Barazia gjinore

- 49.1 Pjesëtarët e njëres gjini duhet të përbëjnë, për aq sa është e mundshme, të paktën një të tretën e anëtarëve të çdo organi shumanëtarësh të shtetit.
- 49.2 Zgjedhja që bëjnë qytetarët mund të shpërfilllet vetëm për aq sa e domosdoshme që pjesëtarët e njëres gjini të përbëjnë një të tretën e anëtarëve të një organi shumëantarësh.
- 49.3 Çdo veprim për qëllime të këtij neni duhet të jetë në pajtim me paragrafin 20.3.

Neni 50. Veprimi qytetar

- 50.1 Çdo qytetar ka të drejtë t'u parashtojë kërkesë autoriteteve botore dhe të ndikojë demokratikisht në vendimmarrje.
- 50.2 Askush nuk mund të përdorë detyrën botore me qëllim që t'i shërbejë drejtpërdrejt interesit vetjak ose të më të afërmeve.

50.3 Çdo qytetar ka të drejtë t'i bëjë qëndresë kujdo që përpiqet të përmbysë rendin kushtetutor dhe qytetari nuk ka mundësi tjetër me mbrojtë rendin.

Neni 51. Mbrojtja e demokracisë

51.1 Ish-zyrtarëve shtetërorë mund t'u kufizohet me ligj dhe për një afat të arsyeshëm pjesëmarrja në:

- (1) veprimtarinë ekonomike që kishin për detyrë zyrtare ta rregullojnë ose mbikëqyrin; ose
- (2) veprimtari ekonomike që ka për qëllim të ndikojë në punën e qeverisë.

51.2 Me përjashtim të shpenzimeve të vogla që bëjnë qytetarët e veçantë, ligji mund të kufizojë shpenzimet private që kanë për qëllim të ndikojnë në zgjedhjet dhe mund t'u kërkojë shpenzuesve të identifikohen.

Nënkreu E. Familja

Neni 52. Mbrojtja e familjes

52.1 Familja përbën gurthemelin e shoqërisë dhe gëzon mbrojtjen e veçantë të shtetit.

52.2 Çdo prind ka të drejtën e pushimit të lehonisë me pagesë, para dhe pas lindjes së fëmijës.

52.3 Shteti nxit shtimin e popullsisë dhe ndihmon çdo prind në nevojë me i rritë dhe eduku fëmijët.

Neni 53. Martesa

53.1 Dy veta të moshës martesore që nuk janë në lidhje të ngushtë gjaku ose tamblu kanë të drejtë që, me pëlqim të lirë dhe në përputhje me ligj, të martohen dhe të krijojnë familje.

53.2 Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe mbështetet në barazinë e bashkëshortëve.

Neni 54. Fëmijët

- 54.1 Çdo fëmijë ka hak kujdesin për mirëqenien e tij dhe të mbrojtjes nga dhuna, keqtrajtimi, dhe shfrytëzimi.
- 54.2 Të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën duhet të jenë në interesin më të mirë të fëmijës.
- 54.3 Çdo fëmijë ka të drejtë të mbajë kumtime të rregullta vetjake dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit dhe gjyshërit e vet, përveçse kur organi përgjegjës kufizon kumtimet ose kontaktet e tilla.

Neni 55. Prindërit

- 55.1 Çdonjëri i moshës madhore ka detyrë të kujdeset për prindin a vjehrrin e vet të moshuar a të paaftë.
- 55.2 Çdonjëri që kujdesin parësor ndaj prindit a vjehrrit ia lë në dorë shtetit ka detyrë të mbulojë shpenzimet e kujdesit.

Nënkreu E. Jetesa e ndershme**Neni 56. Liria e zhvillimit**

- 56.1 Çdonjëri ka të drejtën të gëzojë shëndetin, të zhvillojë shqisën dhe mendjen, dhe të kërkojë lumturinë vetë dhe si pjesëtar i shoqërisë. Kjo e drejtë përfshin të drejtën me përfitu nga të mirat e artit, shkencës, teknologjisë, dhe përparimit të gjithëmbarshtëm njerëzor.

Neni 57. E drejta e pronës

- 57.1 Çdonjëri ka të drejtë ta gëzojë paqësisht pronën e vet. Kjo e drejtë përfshin të drejtën me bartë pronësinë përmes shitblerjes, dhurimit, ose trashëgimisë.
- 57.2 Shteti mund t'i marrë pronën njërit vetëm:
- (1) sipas ligjit;
 - (2) për përdorim botor;
 - (3) kur shpronësimi është i domosdoshëm për arritjen e një qëllimi botor; dhe

(4) pasi t'i ketë pagu pronarit vleftën që prona ka në treg ditën që shpallet shpronësimi.

- 57.3 Pronari mund ta rikthejë pronën që i është marrë për të përmbushë detyrime ligjore, duke i përmbushë në plotni detyrimet në çdo kohë para se pronën ta blejë në mirëbesim një palë e tretë.
- 57.4 Detyruesi nuk mund të shkagojë ofertën e të detyruarit për të përmbushë detyrimet në plotni ose sipas kontratës.

Neni 58. E drejta e plangut

- 58.1 Çdonjëri ka të drejtë të shfrytëzojë plangun. Plangu përbën, deri në madhësinë ose vlerën e arsyeshme, pronën që pronari ose bashkëshorti, prindërit, a fëmijët e mitur të pronarit e përdorin për banim ose për bujqësi mbijetese.
- 58.2 Askujt nuk mund t'i merret plangu ose t'i detyrohet shitja e plangut, përveçse:
- (1) në rast shpronësimi në përputhje me paragrafin 57.2;
 - (2) për të la huanë e dhënë për blerjen e plangut;
 - (3) për të përmbushë detyrimet për punime të kryera në plang;
 - (4) për të përmbushë detyrimet tatimore;
 - (5) për të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga një barrë e vendosur mbi pronën para bartjes së pronësisë;
 - (6) për të mbulu shpenzimet e nevojshme për kujdesin ndaj fëmijës së pronarit, nëse fëmija nuk jeton me pronarin; ose
 - (7) për të mbulu shpenzimet e nevojshme për kujdesin ndaj prindit të moshuar a të paaftë të pronarit, nëse pronari ia ka besu shtetit kujdesin parësor për prindin.
- 58.3 Në rast të një mosmarrëveshjeje lidhur me cilësimin e plangut, pala që kërkon ta marrë pronën ose ta detyrojë shitjen e pronës ka barrën për të dëshmu se prona nuk cilësohet si plang.
- 58.4 Të ardhurat nga shitja e plangut mbrohen, për të paktën një vit, në të njëjtën mënyrë si plangu.

Neni 59. E drejta e punës

- 59.1 Çdonjëri ka të drejtë me punu, duke zgjedhë dhe ushtru lirshëm zanatin dhe duke zgjedhë vendin e punës.
- 59.2 Çdonjëri ka të drejtën e lirisë së sipërmarrjes. Kjo e drejtë përfshin të drejtën me nisë dhe zhvillu veprimtari ekonomike sipas ligjit.
- 59.3 Çdonjëri ka të drejtën e lirisë së punës mendore, që përfshin punën akademike, hulumtimin shkencor, shpikjet e risimet, dhe krijimitarinë artistike, letrare, e shkencore.
- 59.4 Çdo autori ose shpikësi i takojnë, sipas ligjit, privilegje të caktuara mbi veprën ose idenë e vet. Privilegjet e tilla jepen me qëllim që njëkohësisht:
- (1) me i nxitë autorët dhe shpikësit me botu vepra dhe ide të reja; dhe
 - (2) me mbrojtë lirinë e të tjerëve për me i përdorë veprat e botuara dhe idetë e njohura.
- 59.5 Çdonjëri që zgjedh me u marrë me bujqësi ka të drejtë me i rujtë, shpërnda, shumu, dhe shitë bimët ushqimore dhe shtazët që i ka rritë ligjërisht.

Neni 60. E drejta për grevë

- 60.1 Punonjësit kanë të drejtën për grevë që ka të bëjë me marrëdhëniet e punës.
- 60.2 E drejta për grevë mund të kufizohet me ligj për kategori të veçanta punonjësish për t'i siguru shoqërisë shërbimet e domosdoshme.

Neni 61. Mbrojtja shoqërore

- 61.1 Çdonjëri ka të drejtën e ndihmës së shoqërisë, në pajtim me ligj, për të siguru, sipas aftësive të veta, një jetesë të denjë dhe të ndershme.
- 61.2 Rregullohet me ligj kujdesi shëndetësor dhe sigurimi shoqëror themelor për rastet e papunësisë, sëmundjes, aftësisë së kufizuar, dhe moshës së shtyrë.

- 61.3 Të zënët me punë kanë të drejtë të gëzojnë kushte të denja dhe të sigurta për punë, të cilat përfshijnë orarin e arsyeshëm dhe pushimin vjetor të paguar.

Neni 62. E drejta e arsimimit

- 62.1 Çdonjëri ka të drejtë dhe detyrë të ndjekë shkollimin themelor dhe shkollimin ose aftësimin shtesë të përcaktuar me ligj.
- 62.2 Ngrehimet arsimore sigurojnë për çdonjërin mundësi të barabarta për t'u arsimu sipas aftësive dhe mbëhivë të veta të posaçme.
- 62.3 Shteti u jep ndihmën e nevojshme financiare qytetarëve dhe pjesëtarëve të kombit shqiptar që nuk kanë mjete të mjaftueshme për t'i mbulu shpenzimet e shkollimit në ngrehimet botore.

Neni 63. Mjedisi jetësor

- 63.1 Çdonjëri është përgjegjës për natyrën, gjithllojshmërinë e gjallesave, dhe trashëgiminë kombëtare e kulturore.
- 63.2 Gjatë marrjes së një vendimi, organet shtetërore kanë parasysh ndikimin që vendimi mund të ketë në mjedisin jetësor.

Neni 64. Të drejtat teknologjike

- 64.1 Asnjëri nuk mund të detyrohet që, për të gëzu të drejtat e veta, të përdorë ose të paguajë për mjete, ndërtimin e brendshëm të të cilave nuk mund ta qasë, ndryshojë, ose shpërndajë lirshëm.
- 64.2 Çdonjëri ka të drejtë të studiojë funksionimin e një mjeti që ka në pronësi ose ka marrë me qira dhe të botojë atë që mëson rreth atij mjeti. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm me marrëveshje të lidhur përmes negocimit individior.

Nënkreu F. Të drejtat e kombësive

Neni 65. Përcaktimi

- 65.1 Kombësitë janë bashkësi kombëtare, kulturore, gjuhësore, ose fetare, trashëgimisht të pranishme në Dardani.

- 65.2 Të drejtat e kombësive u përkasin njëloj kombësive në tërësi dhe pjesëtarëve të tyre veç e veç.
- 65.3 Çdonjëri ka të drejtë të zgjedhë lirisht me u trajtu ose mos me u trajtu si pjesëtar i një kombësie.

Neni 66. Roli i shtetit

- 66.1 Shteti mbron dhe ndihmon kombësitë të ruajnë dhe zhvillojnë vetëvetësinë, gjuhën, dhe kulturën e tyre.
- 66.2 Shteti nxit dhe ruan tolerancën e bashkëjetesën mes pjesëtarëve të kombësive të ndryshme.
- 66.3 Zbatohen drejtëpërsëdrejti Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Karta Evropiane për Gjuhët Rajonore ose të Pakicave.

Neni 67. Të drejtat simbolike dhe gjuhësore

- 67.1 Kombësitë kanë të drejtë që, sipas ligjit:
- (1) të shfaqin simbolet e tyre;
 - (2) të përfaqësohen në emërtime vendesh në rrethet ku banojnë; dhe
 - (3) të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre.
- 67.2 Mediet botore duhet të transmetojnë program dhe të botojnë përmbajtje të mjaftueshme në gjuhët e kombësive.

Neni 68. Të drejtat arsimore

- 68.1 Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë të ndjekin falas shkollimin parafillor, fillor, dhe të mesëm në gjuhët e tyre.
- 68.2 Numri i nxënësve që kërkohet me ligj për themelimin e klasave dhe shkollave nuk mund të paragjykojë pakicat.
- 68.3 Shteti mundëson arsimin e lartë në gjuhët shqipe dhe sërbe.

Neni 69. Përfaqësimi dhe punësimi

- 69.1 Kombësitë dhe pjesëtarët e tyre kanë hak përfaqësimin e barabartë në punësim në të gjitha organet shtetërore dhe ngrehimet e ndërmarrjet botore.
- 69.2 Përbërja e organeve shtetërore që veprojnë brenda një hapësire tokësore të caktuar duhet të pasqyrojnë për aq sa është e mundshme praninë e kombësive në atë hapësirë.

KREU III. PRIJETARI

Nënkreu A. Përcaktimi dhe tagri

Neni 70. Përcaktimi

- 70.1 Prijetari është kreu i shtetit dhe përfaqëson njëshmërinë e popullit.
- 70.2 Prijetari mbron mbarëvajtjen demokratike e të kushtetutshme të organeve shtetërore dhe përfaqëson shtetin brenda e jashtë.

Neni 71. Tagri

Prijetari ka tagër:

- (1) të nxjerrë dekrete;
- (2) të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare;
- (3) të pranojë letrat kredencore të krerëve të shpurave të huaja diplomatike;
- (4) të vendojë për dërgimin e shpurave diplomatike e konsullare të Dardanisë dhe të emërojë e shkarkojë krerët e tyre;
- (5) të japë, sipas ligjit, medalje, mirënjohje, dhe çmime;
- (6) të shpallë falje individuale, sipas ligjit;
- (7) t'i drejtohet, së paku një herë në vit, Kuvendit rreth gjendjes së vendit dhe veprimtarisë së Prijetarit; dhe
- (8) të bartë përgjegjësi tjera të caktuara me Kushtetutë dhe ligj.

Nënkreu B. Zgjedhja

Neni 72. Përcaktimi

- 72.1 Qytetarët me të drejtë vote e zgjedhin Prijetarin në zgjedhje të përgjithshme e të drejtpërdrejta.
- 72.2 Zgjedhjet e rregullta mbahen të dielën e dytë të majit, vitin që i mbaron mandati Prijetarit.

Neni 73. Cilësimi

- 73.1 Mund të zgjedhet Prijetar çdo qytetar dardan që, ditën që zgjedhet:
- (1) ka mbushë moshën 40-vjeç; dhe
 - (2) nuk është përfshi, brenda tri viteve të fundit, në parti ose veprimtari politike.
- 73.2 Mund të kandidohet për Prijetar çdo qytetar që përmbush kushtet për t'u zgjedhë dhe ka përkrahjen e tremijë qytetarëve.
- 73.3 I zgjedhuri Prijetar nuk mund të rizgjedhet më shumë se dy herë.
- 73.4 Nuk mund të kandidohet në zgjedhjet e radhës qytetari që sapo është shkarku ose ka dhënë dorëheqje nga detyra e Prijetarit.

Neni 74. Votimi i parë

- 74.1 Votuesit mund ta miratojnë, kundërshtojnë, ose shpërfillin secilin kandidat veç e veç.
- 74.2 Për çdo herë që miratohet, kandidati merr një pikë, dhe për çdo herë që kundërshtohet, kandidatit i hiqet një pikë.
- 74.3 Quhet i zgjedhur Prijetar kandidati që ka gjithsej më së shumti pikë dhe e miratojnë mbi gjysma e të gjithë votuesve.

Neni 75. Dytësimi

- 75.1 Nëse asnjë kandidat nuk zgjedhet Prijetar, mbahet votimi dytësues të dielën e dytë pas votimit të parë.
- 75.2 Në votimin dytësues, votuesit zgjedhin njërin nga dy kandidatët që morën më së shumti pikë në votimin e parë.

75.3 Quket i zgjedhur Prijetar kandidati që merr shumicën e votave të vlefshme.

Nënkreu C. Mandati

Neni 76. Fillimi dhe afati

- 76.1 I zgjedhuri Prijetar pranon detyrën e Prijetarit tri javë pas ditës që mbahet votimi i parë.
- 76.2 Mandati i Prijetarit fillon ditën që Prijetari bën betimin, por jo më vonë se shtatë ditë pas ditës që vërtetohet zgjedhja.
- 76.3 Mandati i Prijetarit zgjat jo më shumë se katër vjet, përveç nëse Kushtetuta parasheh ndryshe.

Neni 77. Zbrazëtia

- 77.1 Zyra e Prijetarit lihet zbrazët nëse:
- (1) i zgjedhuri Prijetar nuk bën betimin; ose
 - (2) Prijetari shkarkohet, jep dorëheqje, ose vdes.
- 77.2 Nëse zyra e Prijetarit lihet zbrazët, ushtrues-detyre Prijetari shpall zgjedhje të parakohshme, të cilat mbahen brenda 60 ditëve pas ditës që lihet zbrazët zyra e Prijetarit.

Neni 78. Papajtueshmëria

Prijetari nuk mund të ushtrojë asnjë detyrë tjetër botore dhe as të jetë anëtar i një partie politike.

Neni 79. Shlirime

Prijetari lirohet nga ndjekja për shkelje të ndëshkueshme, paditë qytetare, ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet që merr brenda fushëveprimit të Prijetarit.

Nënkreu Ç. Mungesa dhe shkarkimi

Neni 80. Ushtrues-detyre Prijetari

- 80.1 Kryetari i Kuvendit është ushtrues-detyre Prijetari për aq kohë sa Prijetari të jetë i paaftë me i përmbushë përgjegjësitë e veta ose kur zyra e Prijetarit lihet zbrazët. Por i njëjti qytetar nuk mund të jetë ushtrues-detyre Prijetari për më gjatë se gjatë muaj rresht.
- 80.2 Ushtrues-detyre Prijetari merr përgjegjësitë nëse Prijetari ia jep vetë ato ose Kuvendi vlerëson me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve se Prijetari është përkohësisht i paaftë me i përmbushë përgjegjësitë e veta. Prijetari rimerr përgjegjësitë kur të jetë i aftë me i përmbushë ato.

Neni 81. Shkarkimi

Prijetari mund të shkarkohet nëse:

- (1) është dënu për kryerjen e një krimi të rëndë;
- (2) nuk është ose nuk do të jetë në gjendje t'i përmbushë përgjegjësitë e veta për shkak të sëmundjes së rëndë që zgjat më shumë se gjashtë muaj; ose
- (3) ka shkelë rëndë Kushtetutën.

Neni 82. Ecuria e shkarkimit

- 82.1 Një e treta e të gjithë ligjvënësve i paraqesin Kuvendit kërkesën për ta shkarku Prijetarin. Kërkesa bëhet me shkrim dhe cek arsyet për ta shkarku Prijetarin.
- 82.2 Nëse kërkesa cek sëmundjen si arsye për shkarkim, Kuvendi kërkon mendimin e këshillit mjekësor për gjendjen shëndetësore të Prijetarit.
- 82.3 Nëse kërkesa pandeh se Prijetari ka shkelë rëndë Kushtetutën, Kuvendi kërkon mendimin e Gjykatës Kushtetutore. Gjykata Kushtetutore ia dorëzon mendimin e saj Kuvendit brenda 14 ditëve vijuese.
- 82.4 Kuvendi shqyrton mendimin që ka kërku dhe, me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve, shkarkon Prijetarin.

KREU IV. KUVENDI

Nënkreu A. Përcaktimi dhe tagri

Neni 83. Përcaktimi

- 83.1 Kuvendi ushtron pushtetin ligjvënës.
- 83.2 Kuvendi ka 60 ligjvënës.
- 83.3 Mund të zgjedhen deri në 10 ligjvënës shtesë, por jo më shumë se ç'është e domosdoshme, për të siguru përfaqësimin e kënaqshëm të bashkësive të nënpërfaqësuar.

Neni 84. Tagri

Kuvendi ka tagër:

- (1) të miratojë ligje, rezoluta, dhe akte të tjera të përgjithshme;
- (2) të miratojë buxhetin shtetëror;
- (3) të mbikëqyrë politikën e jashtme dhe të sigurisë; dhe
- (4) të kryejë detyra tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj.

Nënkreu B. Zgjedhja

Neni 85. Përcaktimi

- 85.1 Zgjedhjet për Kuvendin mbahen të dielën e dytë të majit, vitin që mbaron mandati i ligjvënësve.
- 85.2 Në raste të parapara me Kushtetutë, Prijetari shpall zgjedhje të parakohshme ose jashtëzakonshme, të cilat mund të mbahet në cilindo vit.

Neni 86. Cilësimi

- 86.1 Mund të zgjedhet ligjvënës vetëm qytetari që ka mbushë moshën 25-vjeç.
- 86.2 Kryebashkiakët dhe zyrtarët e tjerë të cilët mbajnë përgjegjësi përmbarimore në shkallë bashkie nuk mund të zgjedhen pa heqë dorë paraprakisht nga detyra e tyre.

- 86.3 Nuk mund të kandidohen ose të zgjedhen pa heqë dorë paraprakisht nga detyra e tyre zyrtarët shtetërorë të cilëve u ndalohet me ligj përfshirja në veprimtari politike.
- 86.4 Nuk mund të kandidohen ata të cilëve, me vendim përfundimtar të gjykatës, u është heqë zotësia juridike me vepru.

Neni 87. Viset zgjedhore

- 87.1 Me ligj, trualli i Dardanisë ndahet në 20 vise zgjedhore me popullsi të barabartë, por duke i marrë parasysh vijat e njësive të mbarështimit dhe ndarjet e natyrshme mes trevave, bashkive, dhe vendbanimeve.
- 87.2 Banorët me të drejtë vote të secilit vis zgjedhin nga tre ligjvënës.
- 87.3 Qytetarët që banojnë jashtë vendit mund të votojnë si banorë të visit ku janë lindë, kanë banu, ose kanë lidhje të dëshmuara të përcaktuara me ligj.

Nënkreu C. Mandati

Neni 88. Përcaktimi

Ligjvënësit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues.

Neni 89. Afati

- 89.1 Mandati i të gjithë anëtarëve fillon ditën që vërtetohen zgjedhjet dhe mbaron 30 ditë para ditës së zgjedhjeve të përgjithshme.
- 89.2 Mandati zgjat jo më shumë se katër vjet, përveç nëse Kushtetuta parasheh ndryshe.

Neni 90. Mbarimi i parakohshëm

- 90.1 Mandati mbaron para kohe ose bëhet i pavlefshëm nëse ligjvënësi:
- (1) nuk bën betimin;
 - (2) jep dorëheqje;
 - (3) emërohet anëtar i Kabinetit;

- (4) mungon gjashtë muaj rresht nga mbledhjet e Kuvendit, përveç rasteve të veçanta, në të cilat dhoma mund të vendosë ndryshe;
- (5) shpallet fajtor për shkelje të ndëshkueshme dhe me vendim të prerë gjyqësor dënohet me një ose më shumë vjet burgim; ose
- (6) vdes.

90.2 Nëse mandati i një ligjvënësi mbaron para kohe, vendi i tij plotësohet sipas ligjit.

Neni 91. Papajtueshmëria

Ligjvënësi nuk mund të mbajë ndonjë post përmbarimor në mbarështimin botor ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi botore dhe as të ushtrojë ndonjë detyrë tjetër përmbarimore që mund t'i ndalohe me ligj.

Neni 92. Shlirime

- 92.1 Ligjvënësi lirohet nga ndjekja ndëshkimore, paditë qytetare, dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet që merr brenda fushëveprimit të ligjvënësit.
- 92.2 Ligjvënësi nuk mund të ndalohe ose burgohet pa pëlqimin e shumicës së të gjithë ligjvënësve përderisa është duke krye detyrat e veta si ligjvënës.

Nënkreu Ç. Rregullimi i brendshëm

Neni 93. Rregullorja e punës

- 93.1 Kuvendi miraton me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve rregulloren e punës.
- 93.2 Rregullorja e punës përcakton organizimin e brendshëm dhe punën e Kuvendit, ligjvënësve, kryesisë, togjeve të ligjvënësve, dhe komisioneve.

Neni 94. Kryesia

- 94.1 Kuvendi zgjedh dhe shkarkon, nga radhët e të paktën tri togjeve më të mëdha të ligjvënësve dhe me shumicën e të gjithë ligjvënësve, kryesinë e përbërë nga kryetari dhe tre nënkryetarë.

94.2 Anëtarët e kryesisë shkarkohen me praninë e të paktën dy të tretave të të gjithë ligjvënësve.

Neni 95. Mbledhjet

95.1 Mbledhjet e Kuvendit janë të hapura.

95.2 Mund të kërkojnë mbledhje të mbyllur Prijetari, Kryeministri, ose një e treta e të gjithë ligjvënësve. Kuvendi miraton kërkesën haptazi me dy të tretat e ligjvënësve të pranishëm.

Neni 96. Orari

96.1 Kuvendi mblidhet të paktën dy herë në vit: të hënën e tretë të janarit dhe të hënën e dytë të shtatorit.

96.2 Mbledhje e jashtëzakonshme mbahet me kërkesë të Prijetarit, të Kryeministrit, ose të një të tretës së ligjvënësve.

Neni 97. Punimet

97.1 Punimet e Kuvendit nuk mund të zhvillohen pa praninë e të paktën gjysmës së ligjvënësve.

97.2 Ligjvënësit votojnë haptazi për çdo vendim që merr Kuvendi.

Neni 98. Komisionet

98.1 Kuvendi ngrit nga radhët e veta komisione për punë të posaçme.

98.2 Një e treta e të gjithë ligjvënësve detyrojnë Kuvendin me ngritë komision hetimor.

Nënkreu D. Ecuria ligjvënëse

Neni 99. Nisma ligjvënëse

Mund t'i parashetrojnë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim një projektligj 10 mijë qytetarë me të drejtë vote, cilido ligjvënës, Prijetari, ose Kabineti.

Neni 100. Miratimi

100.1 Projektligji votohet tri herë: në parim, nen për nen, dhe në tërësi.

- 100.2 Kuvendi mund të vendosë, me kërkesë të Kabinetit ose të një së pestës së të gjithë ligjvënësve, ta shqyrtojë dhe miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar. Kuvendi vendos për procedurën e përshpejtuar brenda shtatë ditëve para ditës që fillon shqyrtimi i projektligjit.
- 100.3 Procedura e përshpejtuar nuk lejohet për projektligjet që duhet të miratohen me shumicë të cilësuar, me përjashtim të projektligjeve për masat e jashtëzakonshme.

Neni 101. Shpallja

- 101.1 Pasi ta miratojë ligjin, Kuvendi ia paraqet atë menjëherë Prijetarit.
- 101.2 Brenda ditës ose shtatë ditëve vijuese, Prijetari shpall ose kthen ligjin në Kuvend për rishqyrtim dhe cek pse po e kthen.
- 101.3 Nëse Prijetari nuk e shpall ose kthen ligjin, ligji vetëshpallet shtatë ditë pas ditës që i paraqitet Prijetarit.
- 101.4 Nëse Prijetari e kthen ligjin, Kuvendi mund ta rimiratojë dhe ta shpallë vetë ligjin pa e ndryshu vetëm me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve.

Neni 102. Hyrja në fuqi

- 102.1 Ligji hyn në fuqi vetëm pasi të shpallet dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
- 102.2 Ligji botohet jo më vonë se 14 ditë pas ditës që shpallet, dhe hyn në fuqi 14 ditë pas ditës që botohet, përveç nëse vetë ligji përcakton ndryshe.

Nënkreu Dh. Vendime të posaçme

Neni 103. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

- 103.1 Kuvendi ratifikon me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve marrëveshjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me:
- (1) truallin, paqen, aleancat, dhe çështjet politike e ushtarake;
 - (2) të drejtat themelore;
 - (3) anëtarësimin në organizata ndërshtetërore; dhe
 - (4) marrjen përsipër të detyrimeve financiare.

103.2 Ratifikohet në Kuvend çdo marrëveshje ndërkombëtare që ka të bëjë me miratimin e ligjeve.

Neni 104. Kushtetutshmëria e marrëveshjeve ndërkombëtare

104.1 Prijetari ose një e pesta e të gjithë ligjvënësve mund t'i kërkojnë Gjykatës Kushtetutore të shqyrtojë kushtetutshmërinë e një marrëveshjeje ndërkombëtare para se marrëveshja të ratifikohet.

104.2 Ditën që i bëhet kërkesa ose gjatë 30 ditëve vijuese, Gjykata Kushtetutore parandalon ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare që nuk është në pajtim me Kushtetutën.

104.3 Nuk mund të ratifikohet një marrëveshje ndërkombëtare të cilën është duke e shqyrtu Gjykata Kushtetutore.

Neni 105. Ligje të posaçme

105.1 Kuvendi miraton me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve ligjet për:

- (1) simbolet kombëtare dhe shtetërore;
- (2) liritë fetare dhe marrëveshjet me bashkësitë fetare; dhe
- (3) festat botore.

105.2 Kuvendi miraton me tri të pestat e të gjithë ligjvënësve ligjet për:

- (1) organet dhe autoritetet posaçërisht të cekura në Kushtetutë;
- (2) ndarjet mbarështimore të truallit të shtetit;
- (3) bashkitë, përfshi themelimin, shuarjen, kufijtë, dhe pushtetet e tyre;
- (4) shtetësinë;
- (5) zgjedhjet dhe referendumet;
- (6) masat e jashtëzakonshme;
- (7) zyrtarët botorë;
- (8) amnistinë; dhe
- (9) arsimin.

Neni 106. Kërkesa për shpërndarje

Dy të tretat e të gjithë ligjvënësve mund t'i kërkojnë Prijetarit ta shpërndajë Kuvendin dhe të shpallë zgjedhje të parakohshme për Kuvendin.

KREU V. KABINETI

Nënkreu A. Përcaktimi dhe tagri

Neni 107. Përcaktimi

107.1 Pushtetin përmbarimor e ushtron Kabineti.

107.2 Kabinetin e përbëjnë Kryeministri, Zëvendëskryeministri, dhe jo më shumë se dhjetë ministra.

Neni 108. Tagri i Kabinetit

Kabineti ka tagër:

- (1) të zbatojë ligjet dhe aktet tjera të miratuara nga Kuvendi;
- (2) të paraqesë dhe të zbatojë politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;
- (3) të mundësojë zhvillimin ekonomik të vendit;
- (4) të marrë vendime dhe të nxjerrë akte nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjeve;
- (5) të paraqesë buxhetin shtetëror;
- (6) të udhëzojë dhe mbikëqyrë punën e organeve të mbarështimit;
- (7) të udhëzojë veprimtarinë dhe zhvillimin e shërbimeve botore;
- (8) të bartë përgjegjësi tjera të parapara me Kushtetutë dhe ligj; dhe
- (9) të bartë përgjegjësi tjera përmbarimore të cilat nuk u janë caktu organeve tjera qendrore ose vendore.

Neni 109. Tagri i Kryeministrit

Kryeministri ka tagër:

- (1) ta udhëheqë dhe përfaqësojë Kabinetin;

- (2) të sigurojë zbatimin e politikave të Kabinetit;
- (3) të emërojë, me miratimin e Kuvendit, anëtarët e Kabinetit;
- (4) të shkarkojë, pa pëlqimin e Kuvendit, anëtarët e Kabinetit;
- (5) të këshillohet me Prijetarin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit; dhe
- (6) të bartë përgjegjësi tjera të parapara me Kushtetutë dhe ligj.

Nënkreu B. Zgjedhja

Neni 110. Mandatimi nga Prijetari

- 110.1 Brenda 14 ditëve pas ditës që mbahet mbledhja e parë e Kuvendit ose ditës që jep dorëheqje Kabineti, Prijetari cakton një mandatar për ta bërë Kabinetin e ri dhe për të shërby si Kryeministër.
- 110.2 Në caktimin e mandatarit, Prijetari përdor gjykimin e vet dhe nuk është i detyruar ta marrë parasysh përbërjen politike të Kuvendit.

Neni 111. Miratimi në Kuvend

- 111.1 Brenda 14 ditëve pas ditës në të cilën caktohet, mandataria ia paraqet Kuvendit programin dhe emrat e anëtarëve të Kabinetit të ri. Pastaj, Kuvendi vendos menjëherë, pa debat, me votim të hapur, dhe me shumicën e të gjithë ligjvënësve, nëse do ta miratojë bërjen e Kabinetit të ri.
- 111.2 Brenda shtatë ditëve pas ditës së miratimit nga Kuvendi, Kabineti i ri paraqitet para Prijetarit për ta bërë betimin dhe për ta pranuar detyrën.

Neni 112. Përmbysja e mandatarit

- 112.1 Nëse Kuvendi nuk e miraton bërjen e Kabinetit të ri, ose mandataria nuk është në gjendje ose nuk pranon ta bëjë Kabinetin e ri, mandataria quhet i përmbysur.
- 112.2 Prijetari cakton një mandatar të dytë brenda shtatë ditëve pas ditës që përmbysët mandataria i parë. Mandataria i dytë caktohet në të njëjtën mënyrë dhe ka të njëjtat detyra dhe kushte si mandataria i parë.

Neni 113. Mandatimi nga Kuvendi

- 113.1 Nëse Prijetari nuk e cakton mandatarin e dytë brenda afatit, ose përmbysset edhe mandatarin e dytë, të drejtën me caktim mandatarin e merr Kuvendi.
- 113.2 Mandatarin që e cakton Kuvendi ka të njëjtat detyra dhe kushte, por mund të mos ketë të njëjtin afat, si një mandatar që e cakton Prijetari.
- 113.3 Nëse, brenda 14 ditëve pas ditës që të drejtën me caktim mandatarin e merr Kuvendi, nuk paraqitet një Kabinet i ri para Prijetarit, Prijetari mund ta shpërndajë Kuvendin.

Neni 114. Ribërja e Kabinetit

- 114.1 Kryeministri ose një e treta e të gjithë ligjvënësve mund t'i kërkojnë Kuvendit ta ribërë Kabinetin. Parashtruesi i kërkesës cakton njëkohësisht një mandatar të ri për ta bërë Kabinetin e ri dhe për të shërby si Kryeministër.
- 114.2 Brenda shtatë ditëve pas ditës që bëhet kërkesa, mandatarin e ri ia paraqet Kuvendit programin dhe përbërjen e Kabinetit të ri. Pastaj, Kuvendi vendos menjëherë, pa debat, me votim të hapur, dhe me shumicën e të gjithë ligjvënësve, nëse do ta miratojë bërjen e Kabinetit të ri.
- 114.3 Kërkesa për ribërjen e Kabinetin nuk mund të përsëritet brenda 90 ditëve.

Neni 115. Dorëheqja e Kabinetit

- 115.1 Nëse Kuvendi miraton bërjen e Kabinetit të ri, Kabineti paraprak quhet në dorëheqje deri në kohën kur Kabineti i ri ta marrë detyrën.
- 115.2 Nëse Kuvendi nuk miraton bërjen e Kabinetin të ri, Kabineti i tashëm mbetet në detyrë.

Nënkreu C. Puna

Neni 116. Përgjegjësia

- 116.1 Kabineti, për punën e vet, i përgjigjet Kuvendit.

- 116.2 Anëtari i Kabinetit mban bashkëpërgjegjësi për vendimet që merr Kabineti, përveç nëse anëtari kundërshton vendimin në kohën që ai merret dhe e dëshmon kundërshtimin.
- 116.3 Anëtari i Kabinetit mban përgjegjësi të veçantë për vendimet që merr në fushëveprimin e vet.

Neni 117. Shlirime

Anëtari i Kabinetit lirohet nga ndjekja për shkelje të ndëshkueshme, paditë qytetare, dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet që merr brenda fushëveprimit të anëtarit të Kabinetit.

Neni 118. Rregullimi i brendshëm

- 118.1 Mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në Kabinet përcaktohen me ligj dhe me rregullore.
- 118.2 Një këshill i pavarur mbikëqyrës siguron respektimin e rregullave dhe parimeve për shërbimin qytetnor.

KREU VI. GJYQËSIA

Nënkreu A. Parime të përgjithshme

Neni 119. Përcaktimi

- 119.1 Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat e pavarura dhe jopolitike.
- 119.2 Gjykatat ndajnë drejtësinë sipas Kushtetutës, ligjeve tjera, dhe vendimeve paraprijëse gjyqësore.
- 119.3 Vendimet gjyqësore janë të detyrueshme për të gjitha organet shtetërore.

Neni 120. Kushtetutshmëria

- 120.1 Gjykatat nuk i zbatojnë ligjet që janë në kundërshtim me Kushtetutën.
- 120.2 Gjykatat mund t'i kërkojnë Gjykatës Kushtetutore të shqyrtojë çështje kushtetutore.

Neni 121. Lëndët gjyqësore

121.1 Gjykatat shqyrtojnë vetëm lëndë ose mosmarrëveshje të mirëfillta mes palëve kundërshtare që paraqiten para gjykatës.

121.2 Një lëndë ose mosmarrëveshje quhet e mirëfilltë kur njëra palë i kërkon gjykatës ta ndalojë një ligj ose veprim që po dëmton ose është gati me dëmtu palën ose kur njëra palë kërkon dëmshpërblim për dëmet që ka pësuar.

Neni 122. Pagjykueshmëria

122.1 Pos kur Kushtetuta përcakton ndryshe, gjykatat nuk japin mendime këshilluese as nuk shqyrtojnë raste në të cilat vendimi i gjykatës nuk do të jetë i plotfuqishëm.

122.2 Gjykatat nuk shqyrtojnë raste politike, përfshi çështjet që u janë besu ose mund të zgjidhen më mirë kur u lihen në dorë organeve shtetërore që u nënshtrohen zgjedhjeve të drejtpërdrejta.

Nënkreu B. Gjykatat**Neni 123. Gjykatat themelore dhe ankimore**

123.1 Gjykatat themelore janë gjykata të shkallës së parë.

123.2 Gjykatat ankimore janë gjykata më të larta, të cilat rishikojnë vendimet e gjykatave të shkallës së parë pas ankimit të njërës palë.

123.3 Vendimet e një gjykate ankimore janë të detyrueshme për gjykatat e shkallës së parë mbi të cilat ka tagër gjykata ankimore.

Neni 124. Gjykata e Naltë

124.1 Gjykata e Naltë është gjykata më e lartë për çështje jokushtetutore në Dardani. Gjykata e Naltë rishikon vendimet e gjykatave ankimore pas lutes së njërës palë.

124.2 Pos rasteve të përcaktuara me ligj, Gjykata e Naltë shqyrton lëndët për shqyrtimin e të cilave japin pëlqimin dy të pestat e gjyqtarëve të Gjykatës së Naltë.

124.3 Vendimet e Gjykatës së Naltë janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat.

Neni 125. Rregullimi

- 125.1 Ndërtimi, puna, dhe tagri i gjykatave rregullohet me ligj.
- 125.2 Një gjykatë e posaçme mund të themelohet me ligj kur themelimi i saj të jetë i nevojshëm.
- 125.3 Nuk mund të ketë gjykata të jashtëzakonshme.

Nënkreu C. Gjyqtarët

Neni 126. Mandati

- 126.1 Gjyqtarët i emëron, riemëron, dhe shkarkon Këshilli Gjyqësor me pëlqimin e Prijetarit.
- 126.2 Gjyqtari shërben fillimisht për tri vjet.
- 126.3 Nëse riemërohet, gjyqtari shërben deri në moshën ligjore të pensionimit, përveç nëse shkarkohet.

Neni 127. Pavarësia dhe papajtueshmëria

- 127.1 Gjyqtarët në punën e tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.
- 127.2 Gjyqtari nuk mund:
- (1) të ushtrojë ndonjë detyrë në organet shtetërore jashtë gjyqësisë;
 - (2) të përfshihet në ndonjë veprimtari politike ose ndonjë veprimtari tjetër të ndaluar me ligj; ose
 - (3) të përfshihet në veprim ose sjellje që bie ndesh me pavarësinë, paanësinë, ose denjësinë e gjyqtarit.

Neni 128. Shlirime

- 128.1 Gjyqtari ose gjyqtari porot lirohet nga ndjekja për shkelje të ndëshkueshme, paditë qytetare, dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet që merr brenda fushëveprimit të gjyqtarit.
- 128.2 Gjyqtari dhe gjyqtari porot nuk gëzon shirim nëse shkel ligjin qëllimisht.
- 128.3 Kur një gjyqtar ngarkohet me shkelje të ndëshkueshme ose ndalohet, organet e rendit njoftojnë pa vonesë Këshillin Gjyqësor.

Neni 129. Bartja

Gjyqtarët nuk mund të barten kundër vullnetit të tyre, përveçse për mbarrëvajtjen e gjyqësorit, për zbatimin e masave disiplinore, ose kur me ligj parashihet ndryshe.

Neni 130. Shkarkimi

130.1 Një gjyqtar mund të shkarkohet nëse:

- (1) dënohet për krim të rëndë;
- (2) shpallet i paaftë mendërisht ose trupërisht; ose
- (3) shpërfill rëndë detyrat e gjyqtarit.

130.2 Gjyqtari i shkarkuar ka të drejtë të ankohet ndaj shkarkimit drejtpërdrejt në Gjykatën e Naltë.

Nënkreu Ç. Këshilli gjyqësor

Neni 131. Përcaktimi dhe tagri

131.1 Këshilli Gjyqësor është organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili siguron pavarësinë, paanësinë, dhe profesionizmin e gjykatave dhe gjyqtarëve.

131.2 Këshilli Gjyqësor ka tagër:

- (1) të përzgjedhë, emërojë, dhe riemërojë gjyqtarët;
- (2) të bartë dhe disjplinojë gjyqtarët;
- (3) të përpilojë rregulla sipas ligjit për punën e gjykatave;
- (4) të mbikëqyrë dhe mbarështojë gjykatat;
- (5) të hartojë dhe mbikëqyrë buxhetin e gjykatave;
- (6) përcaktojë numrin e gjyqtarëve të nevojshëm;
- (7) rekomendojë themelimin e gjykatave të reja; dhe
- (8) të njoftojë Kuvendit, të paktën një herë në vit, për gjendjen e gjyqësisë.

Neni 132. Përbërja

132.1 Këshilli Gjyqësor ka 13 anëtarë me cilësime dhe përvojë profesionale.

132.2 Gjyqtarët emërojnë pesë dhe Kuvendi tetë anëtarë të Këshillit Gjyqësor. Prej anëtarëve që emëron Kuvendi, dy janë gjyqtarë dhe një avokat.

132.3 Anëtarët e Këshillit Gjyqësor shërbejnë për pesë vjet.

132.4 Kushtet për të qenë anëtar i Këshillit Gjyqësor rregullohen me ligj.

Neni 133. Puna

133.1 Këshilli Gjyqësor përzgjedh, emëron, dhe riemëron gjyqtarët sipas meritës, përmes një ecurie të hapur, dhe sipas kritereve të përcaktuara me ligj.

133.2 Kur emëron ose riemëron një gjyqtar të një gjykate, Këshilli Gjyqësor këshillohet me gjykatën.

133.3 Rregullimi i brendshëm i Këshillit Gjyqësor përcaktohet me ligj.

KREU VII. GJYKATA KUSHTETUTORE

Nënkreu A. Përcaktimi dhe tagri

Neni 134. Përcaktimi

134.1 Gjykata Kushtetutore është gjykatë e posaçme përgjegjëse për ndërpreimin përfundimtar të Kushtetutës.

134.2 Gjykata Kushtetutore ka 12 gjyqtarë kushtetutorë.

134.3 Pos kur Kushtetuta përcakton ndryshe, shqitjet që vlejné për gjykatat tjera vlejné edhe për Gjykatën Kushtetutore.

Neni 135. Tagri

135.1 Gjykata Kushtetutore vendos për çështjet që burojnë nga Kushtetuta ose marrëveshjet ndërkombëtare.

135.2 Mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetutore:

(1) Kuvendi, Prijetari, Kabineti, dhe Avokati i Popullit për shqyrtimin e ligjeve dhe akteve të organeve shtetërore;

(2) dhjetë deputetë për shqyrtimin e ligjeve të miratuara para se ato të hyjnë në fuqi;

- (3) gjykatat për shqyrtimin e akteve të kontestuara në procedura gjyqësore;
- (4) cilido deputet për shqyrtimin e akteve që cenojnë të drejtat e kombësive;
- (5) palët që u janë shkelë të drejtat, por pasi të kenë shterë mjetet juridike; dhe
- (6) palët tjera të autorizuara me ligj.

135.3 Pos kur Kushtetuta përcakton ndryshe, Gjykata Kushtetutore shqyrton çështjet në pajtim me nenet 121 dhe 122.

135.4 Gjykata Kushtetutore ka të drejtë vetëm t'i shfuqizojë ligjet, vendimet, ose veprimet që shqyrton.

Nënkreu B. Gjyqtarët kushtetutorë

Neni 136. Emërimi

136.1 Gjyqtarët kushtetutorë i emëron Prijetari me miratimin e shumicës së të gjithë ligjvënësve në Kuvend.

136.2 Mund të emërohen gjyqtarë kushtetutorë juristët me cilësim të lartë dhe me përvojë pune jo më pak se 15 vjet.

136.3 Një e katërta e gjyqtarëve kushtetutorë emërohen çdo katër vjet.

136.4 Kryetarin dhe nënkryetarin e Gjykatës Kushtetutore e emëron nga radhët e gjyqtarëve kushtetutorë Prijetari me miratimin e shumicës së të gjithë ligjvënësve në Kuvend.

Neni 137. Emërimi

137.1 Gjyqtari kushtetutor fillon detyrën pasi të bëjë betimin para Prijetarit.

137.2 Gjyqtari kushtetutor shërben jo më shumë se 12 vjet, përveç kur nuk emërohet me kohë pasardhësi i tij.

137.3 I njëjti qytetar nuk mund të riemërohet gjyqtar kushtetutor.

137.4 Gjyqtari kushtetutor largohet para kohe kur:

- (1) dënohet me vendim të prerë për shkelje të ndëshkueshme;

- (2) mungon në detyrë pa arsye për më shumë se gjashtë muaj;
- (3) mbush moshën 75-vjeç;
- (4) jep dorëheqje; ose
- (5) shpallet me vendim të prerë gjyqësor i paaftë me vepru.

137.5 Largimin para kohe të gjyqtari kushtetutor e shpall Gjykata Kushtetutore.

137.6 Nëse një gjyqtar kushtetutor largohet para kohe, Prijetari emëron, me miratimin e shumicës së të gjithë ligjvënësve në Kuvend, një zëvendësues. Zëvendësuesi shërben deri kur do të shërbente gjyqtari kushtetutor i larguar sikur të mos largohet.

Neni 138. Pavarësia dhe papajtueshmëria

138.1 Gjyqtarët kushtetutorë në punën e tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.

138.2 Gjyqtari kushtetutor nuk mund:

- (1) të ushtrojë ndonjë detyrë në organet shtetërore jashtë gjyqësisë;
- (2) të përfshihet në ndonjë veprimtari politike ose ndonjë veprimtari tjetër të ndaluar me ligj; ose
- (3) të përfshihet në veprim ose sjellje që bie ndesh me pavarësinë, paanësinë, ose denjësinë e gjyqtarit.

Neni 139. Shlirime

139.1 Gjyqtari kushtetutor lirohet nga ndjekja për shkelje të ndëshkueshme, paditë qytetare, dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet që merr brenda fushëveprimit të gjyqtarit kushtetutor.

139.2 Gjyqtari kushtetutor nuk mund të ndalet, t'i hiqet liria në çfarëdo trajte, t'i nënshtrohet kontrollit pa miratimin e vetë Gjykatës Kushtetutore, përveçse kur kapet duke krye ose menjëherë pasi të ketë krye shkelje të ndëshkueshme.

139.3 Nëse gjyqtari kushtetutor ndalet pa miratimin e Gjykatës Kushtetutore, Kryepërndjekësi njofton menjëherë Gjykatën Kushtetutore për ndaljen.

Nëse Gjykata Kushtetutore nuk e miraton brenda 24 orëve vijuese dërgimin para gjykatës së gjyqtarit kushtetutor të ndalur, gjyqtari lirohet.

Neni 140. Shkarkimi

140.1 Gjyqtarin kushtetutor mund ta shkarkojë Kuvendi me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve nëse gjyqtari:

- (1) dënohet për shkelje të ndëshkueshme;
- (2) shpallet i paaftë mendërisht ose trupërisht; ose
- (3) shpërfill rëndë detyrat e gjyqtarit.

140.2 Pasi vendos për ta shkarku një gjyqtar kushtetutor, Kuvendi njofton Gjykatën Kushtetutore. Po atë ditë ose brenda 14 ditëve vijuese, Gjykata Kushtetutore vërteton ligjshmërinë e shkarkimit të gjyqtarit kushtetutor. Nëse vlerëson se shkarkimi është i ligjshëm, Gjykata Kushtetutore shpall shkarkimin e gjyqtarit kushtetutor.

Nënkreu C. Puna

Neni 141. Rregullimi i brendshëm

141.1 Gjykata Kushtetutore regullon, sipas ligjit, organizimin e brendshëm dhe punën e vet, përfshi ecuritë e vendimmarrjes.

141.2 Gjykata Kushtetutore boton raportin vjetor.

Neni 142. Shqyrtimi i lëndëve

142.1 Pos rasteve të përcaktuara me ligj, Gjykata Kushtetutore shqyrton lëndët për shqyrtimin e të cilave japin pëlqimin dy të pestat e gjyqtarëve kushtetutorë.

142.2 Një lëndë shqyrtohet nga një pleqësi e përbërë nga jo më shumë se nëntë gjyqtarë kushtetutorë. Pleqësia shqyrtuese caktohet me short në mënyrën që përcakton vetë Gjykata Kushtetutore.

142.3 Gjykata Kushtetutore vendos për një lëndë me shumicën e të gjithë gjyqtarëve kushtetutorë që shqyrtojnë lëndën.

Neni 143. Fuqia juridike

- 143.1 Vendimet e Gjykatës Kushtetutore janë të prera dhe të detyrueshme.
- 143.2 Vendimi i Gjykatës Kushtetutore hyn në fuqi vetëm pasi të botohet në Fletoren Zyrtare. Vendimi hyn në fuqi ditën që botohet, përveç kur Gjykata Kushtetutore zgjedh një datë më të vonshme.
- 143.3 Vendimi i Gjykatës Kushtetutore botohet jo më vonë se 14 ditë pas ditës që botohet, përveç kur Gjykata Kushtetutore vendos ndryshe.
- 143.4 Mendimi mospajtues i një gjyqtari kushtetutor botohet bashkë me vendimin e Gjykatës Kushtetutore.

Neni 144. Vendime të posaçme

- 144.1 Gjykata Kushtetutore mund t'i përmbarojë përmes Ushtrisë vendimet në lidhje me paragrafët 7.2 dhe 43.2.
- 144.2 Gjykata Kushtetutore mund t'i drejtohet Ushtrisë vetëm pasi organet tjera të shtetit të mos jenë në gatishmëri të përmbarojnë vendimet e Gjykatës Kushtetutore.

KREU VIII. ORGANE TË POSAÇME

Nënkreu A. Përndjekësit shtetërorë

Neni 145. Përcaktimi

- 145.1 Përndjekësit shtetërorë janë zyrtarë të pavarur dhe të paanshëm, përgjegjës për ndjekjen e të dyshuarve për shkelje të ndëshkueshme ose shkelje tjetër të përcaktuar me ligj.
- 145.2 Tagri dhe puna e brendshme e përndjekësve rregullohet me ligj.

Neni 146. Mandati

- 146.1 Përndjekësi shërben fillimisht për tri vjet.
- 146.2 Nëse riemërohet, përndjekësi shërben deri në moshën ligjore të pensionimit, përveç nëse shkarkohet.
- 146.3 Përndjekësi mund të shkarkohet për shkak të dënimit për një krim të rëndë ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave.

Neni 147. Pavarësia dhe papajtueshmëria

147.1 Përndjekësit në punën e tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.

147.2 Përndjekësi nuk mund:

- (1) të ushtrojë ndonjë detyrë në organet shtetërore jashtë përndjekësisë;
- (2) të përfshihet në ndonjë veprimtari politike ose ndonjë veprimtari tjetër të ndaluar me ligj; ose
- (3) të marrë në veprim ose sjellje që bie ndesh me pavarësinë, paanësinë, ose denjësinë e përndjekësit.

Neni 148. Kryepërndjekësi

148.1 Kryepërndjekësin shtetëror e emëron dhe shkarkon Prijetari, sipas paraqitjes së Këshillit Përndjekësor.

148.2 I emëruari Kryepërndjekës shërben për shtatë vjet dhe nuk mund të riemërohet.

Neni 149. Këshilli Përndjekësor

149.1 Këshilli Përndjekësor është organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili siguron pavarësinë, paanësinë, dhe profesionizmin e përndjekësve shtetërorë.

149.2 Këshilli Përndjekësor ka tagër:

- (1) të përzgjedhë kandidatët për përndjekës dhe t'ia paraqesë Prijetarit; dhe
- (2) të bartë dhe të disiplinojë përndjekësit.

149.3 Këshilli Përndjekësor përzgjedh kandidatët për përndjekës sipas meritës, përmes një ecurie të hapur, dhe sipas kriterëve të përcaktuara me ligj.

149.4 Përbërja dhe rregullimi i brendshëm e Këshillit Përndjekësor përcaktohen me ligj.

Nënkreu B. Avokati i Popullit

Neni 150. Përcaktimi dhe tagri

150.1 Avokati i Popullit është organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili mbron të drejtat themelore.

150.2 Avokati i Popullit ka tagër:

- (1) të flasë para Kuvendit kurdoherë që e sheh të vyeshme;
- (2) t'i paraqesë Kuvendit raport vjetor dhe, sipas kërkesës, raporte tjera mbi gjendjen e të drejtave themelore;
- (3) të rekomendojë masa kur vëren shkelje të të drejtave themelore; dhe
- (4) të shtrojë çështje në gjykatë në emër të palëve të dëmtuara.

Neni 151. Emërimi

151.1 Avokatin e Popullit e emëron Kuvendi me shumicën e të gjithë ligjvënësve. Avokat i Popullit ka të drejtë të zgjidhet çdo qytetar i ndershëm:

- (1) me karakter e moral të lartë;
- (2) me arsim të lartë; dhe
- (3) me përvojë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut.

151.2 I emëruari Avokat i Popullit shërben për pesë vjet dhe nuk mund të riemërohet.

Neni 152. Zëvendësi

152.1 Avokati i Popullit ka një ose më shumë zëvendës.

152.2 Të paktën një zëvendës është pjesëtar i kombësive që nuk janë shumicë në Dardani.

152.3 Emërimi i zëvendësve rregullohet me ligj.

Neni 153. Puna

153.1 Avokati i Popullit nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga zyrtarët, organet shtetërore, ose autoritetet tjera.

153.2 Çdo zyrtar, organ shtetëror, ose autoritet tjetër ka detyrë t'i përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'ia paraqesë atij të gjitha dokumentet dhe të dhënat e kërkuara ligjërisht.

153.3 Avokati i Popullit, sipas ligjit, parashtron dhe mbarështon mëvetësisht buxhetin e vet.

Neni 154. Papajtueshmëria

Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij nuk mund:

- (1) të jenë anëtarë të asnjë partie politike;
- (2) të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore, ose private profesioniste; ose
- (3) të marrin pjesë në drejtimin e organizatave qytetare, ekonomike, dhe tregtare.

Neni 155. Shlirime

Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij lirohen nga ndjekja për shkelje të ndëshkueshme, paditë qytetare, ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet që marrin brenda fushëveprimit të Avokatit të Popullit.

Neni 156. Shkarkimi

156.1 Një e treta e të gjithë ligjvënësve mund t'i kërkojnë Kuvendit ta shkarkojë Avokatin e Popullit.

156.2 Kuvendi shkarkon Avokatin e Popullit me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve.

Nënkreu C. Rishikuesi i Përgjithshëm

Neni 157. Përcaktimi dhe tagri

157.1 Rishikuesi i Përgjithshëm është organ i pavarur, i cili mbikëqyr çështjet ekonomike dhe financiare.

157.2 Rishikuesi i Përgjithshëm vëzhgon:

- (1) veprimtarinë ekonomike të organeve shtetërore dhe ngrehimeve botore;
- (2) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve botore;
- (3) veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve botore dhe vetave tjerë juridikë të cilët shteti ka interes pronësor; dhe
- (4) veprimtarinë e kujt do për detyrimet financiare të të cilit shteti ka hy dorëzanë.

Neni 158. Raportimet

158.1 Rishikuesi i Përgjithshëm i paraqet Kuvendit:

- (1) raport vjetor për veprimtarinë e Rishikuesit të Përgjithshëm;
- (2) raport për zbatimin e buxhetit shtetëror;
- (3) mendimin për raportin e Kabinetit për shpenzimet e vitit financiar para se Kuvendi ta miratojë raportin;
- (4) njoftime për rezultatet e kontrolleve sa herë që kërkon Kuvendi.

158.2 Rregullimi i brendshëm dhe tagri shtesë i Rishikuesit të Përgjithshëm përcaktohen me ligj.

Neni 159. Emërimi dhe mandati

159.1 Rishikuesin e Përgjithshëm e emëron Prijetari me miratimin e shumicës së të gjithë ligjvënësve në Kuvend.

159.2 I emëruari Rishikues i Përgjithshëm shërben për pesë vjet dhe mund të riemërohen vetëm një herë.

Neni 160. Shkarkimi

160.1 Prijetari ose një e treta e ligjvënësve mund t'i kërkojë Kuvendi ta shkarkojë Rishikuesin e Përgjithshëm.

160.2 Kuvendi e shkarkon Rishikuesin e Përgjithshëm me shumicën e dy të tretave të të gjithë ligjvënësve.

Nënkreu Ç. Organe tjera

Neni 161. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

161.1 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i pavarur dhe i përhershëm, i cili organizon zgjedhjet dhe referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.

161.2 Komisioni përbëhet nga 11 anëtarë. Gjashtë togjet më të mëdha të ligjvënësve emërojnë nga të paktën një anëtar. Emërimi i anëtarëve tjerë rregullohet me ligj.

161.3 Kryesuesin e Komisionit e emëron Prijetari nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës së Naltë ose gjykatave ankimore.

Neni 162. Banka e Dardanisë

162.1 Banka e Dardanisë është banka qendrore e shtetit dhe ngrehim i pavarur dhe i rregulluar me ligj që ka të drejtën përjashtuese:

- (1) me pre monedhën dardane;
- (2) me zbatu pavarësisht politikën monedhare; dhe
- (3) me i mbajtë dhe mbarështu kursimet valutore të shtetit.

162.2 Për punën e vet, Banka e Dardanisë i përgjigjet vetëm Kuvendit.

Neni 163. Komisioni i Medieve

Komisioni i Medieve është organ i pavarur dhe i rregulluar me ligj që:

- (1) rregullon valët e transmetimit;
- (2) jep leje për transmetuesit botorë dhe privatë;
- (3) përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit; dhe
- (4) bart përgjegjësi tjera sipas ligjit.

Neni 164. Agjencitë e pavarura

164.1 Agjencitë e pavarura janë organe të pavarura dhe profesioniste të themeluara me ligj për të bartë përgjegjësi mbarështuese sipas një udhëzimi të qartë.

164.2 Agjencitë e pavarura kanë buxhetin e tyre dhe e mbarështojnë atë mëvetësisht, sipas ligjit.

164.3 Çdo zyrtar, organ shtetëror, ose autoritet tjetër ka detyrë të bashkëpunojë me agjencitë e pavarura dhe t'u përgjigjet kërkesave që ato bëjnë brenda fushëveprimeve të tyre të veçanta.

Neni 165. Papajtueshmëria

Drejtuesit dhe zyrtarët e lartë të organeve të përcaktuara me këtë pjesë nuk mund të përfshihen në veprimtari politike.

KREU IX. MBROJTJA DHE RENDI

Nënkreu A. Parime të përgjithshme

Neni 166. Përcaktimi

- 166.1 Organet e mbrojtjes dhe rendit varen nga organet qytetnore dhe demokratike.
- 166.2 Kuvendi mbikëqyr, sipas ligjit, buxhetin dhe politikat e organeve të mbrojtjes dhe rendit.

Neni 167. Detyrat e qytetarëve

- 167.1 Qytetarët dardanë kanë detyrë, sipas ligjit, të mbrojnë vendin dhe të shërbejnë në Ushtri.
- 167.2 Qytetari që për arsye ndërgjegjeje nuk pranon me shërby me armë në Ushtri ka detyrë të kryejë një shërbim tjetër sipas ligjit.

Neni 168. Të drejtat e shërbyesve

- 168.1 Nuk mund të zgjedhen ose të emërohen në detyra të tjera shtetërore dhe as të marrin pjesë në parti ose në veprimtari politike:
- (1) ushtarakët e shërbimit vepror;
 - (2) pjesëtarët e Policisë; ose
 - (3) pjesëtarët e njësive të zbulimit.
- 168.2 Pjesëtarët e Ushtrisë ose qytetarët që kryejnë shërbim tjetër të mbrojtjes gëzojnë të gjitha të drejtat themelore, përveçse kur ligji parashikon ndryshe. Por ai ligj duhet të jetë në pajtim me nenet 14 e 15.

Nënkreu B. Organet

Neni 169. Ushtria

- 169.1 Ushtria është forcë përgjegjëse për mbrojtjen e vendit. Ushtria përbëhet nga forcat tokësore, ujore, dhe ajrore.
- 169.2 Prijetari është kryekomandant i Ushtrisë. Në kohë paqëje, Prijetari drejton Ushtrinë nëpërmjet Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes.

169.3 Prijetari, me parashtrim të Kabinetit, emëron dhe shkarkon Kreun e Shtabit të Përgjithshëm dhe komandantët e forcave tokësore, ujore, dhe ajrore.

169.4 Tagri i Prijetarit si kryekomandant i Ushtrisë dhe tagri i komandantëve të Ushtrisë caktohen me ligj.

Neni 170. Këshilli i Mbrojtjes

170.1 Këshilli i Mbrojtjes është organ këshillues për çështje të mbrojtjes. Ai përgatit strategjinë e mbrojtjes shtetërore dhe bart përgjegjësi tjera të caktuara me Kushtetutë dhe ligje tjera.

170.2 Këshillin e Mbrojtjes e kryeson Prijetari, në bashkëpunim me Kryeministrin.

170.3 Mbledhjen e Këshillit të Mbrojtjes mund ta kërkojë në çdo kohë Prijetari, Kryeministri, ose Ministri i Mbrojtjes.

170.4 Kryeministri dhe Ministri i Mbrojtjes janë anëtarë të Këshillit të Mbrojtjes. Anëtarët tjerë përcaktohen me ligj.

Neni 171. Policia

171.1 Policia është organ profesionist përgjegjës për të ruajtë rendin e sigurinë botore dhe për të kontrollu, në bashkëpunim me Ushtrinë, kufirin shtetëror.

171.2 Policia ka zinxhir të njësuar komande në tërë Dardaninë.

171.3 Kryeministri emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë.

171.4 Organizimi i brendshëm i Policisë rregullohet me ligj.

Neni 172. Zbulimi

172.1 Agjencia e Zbulimit është organ profesionist që heton kërcënimet ndaj sigurisë shtetërore.

172.2 Punën e Agjencisë së Zbulimit e mbikëqyr, sipas ligjit, Kuvendi.

172.3 Prijetari, në këshillim me Kryeministrin, emëron drejtorin, zëvendës drejtorin, dhe Rishikuesin e Përgjithshëm të Agjencisë së Zbulimit. Cilësimi dhe mandati i tyre rregullohet me ligj.

172.4 Prijetari dhe Kryeministri marrin të njëjtat informata të zbulimit.

Nënkreu C. Masat e jashtëzakonshme

Neni 173. Përcaktimi

173.1 Masat e jashtëzakonshme mund të ndërmerren për aq sa janë të domosdoshme për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore ose teknologjike.

173.2 Masat e jashtëzakonshme duhet të jenë në përpjesëtim me rrezikun dhe të synojnë me rikthym sa më shpejt gjendjen e rregullt.

Neni 174. Ligjshmëria

174.1 Puna e organeve botore, kufizimi i të drejtave themelore, dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara gjatë kohës që ndërmerren masat e jashtëzakonshme rregullohen me ligj.

174.2 Gjatë kohës sa ndërmerren masat e jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohen:

- (1) Kushtetuta;
- (2) ligjet për zgjedhjet për Kuvendin dhe për organet e pushtetit vendor; ose
- (3) ligjet për masat e jashtëzakonshme.

174.3 Gjatë kohës sa ndërmerren masat e jashtëzakonshme nuk mund të mbahen zgjedhje të përgjithshme ose referendume. Zgjedhjet vendore mund të bëhen vetëm aty ku nuk zbatohen masat e jashtëzakonshme.

Neni 175. Gjendja e luftës

175.1 Në rast agresioni të armatosur kundër vendit, Prijetari, me këshillimin të Kabinetit, shpall me dekret gjendjen e luftës.

175.2 Brenda 48 orëve pasi nënshkruan dekretin, Prijetari ia paraqet atë Kuvendit. Kuvendi menjëherë merr në shqyrtim dekretin dhe e miraton me shumicën e të gjithë ligjvënësve. Dekreti është i pafuqishëm nëse Kuvendi e shqyrton por nuk e miraton atë.

175.3 Në rast kërcënimesh të jashtme, Kuvendi, me kërkesë të Prijetarit, shpall gjendjen e luftës si dhe vendos dhe heq gjendjen e mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm.

Neni 176. Gjendja e jashtëzakonshme

176.1 Në rast rreziku për rendin kushtetutor, Kabineti mund t'i kërkojë Kuvendit të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme në një pjesë ose në krejt vendin. Gjendja e jashtëzakonshme zgjat për aq kohë sa vijon rreziku, por jo më shumë se 60 ditë.

176.2 Me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, Ushtria ndërhyt vetëm me vendim të Kuvendit dhe kur Policia nuk është në gjendje të rivendosë rendin.

176.3 Kuvendi mund ta zgjasë afatin e gjendjes së jashtëzakonshme për 30 ditë me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve, por jo më shumë se tri herë.

Neni 177. Gjendja e fatkeqësisë

177.1 Për të parandalu ose mënjanu pasojat e një fatkeqësie natyrore ose teknologjike, Kabineti mund të shpallë gjendjen e fatkeqësisë në një pjesë ose në krejt vendit. Gjendja e fatkeqësisë shpallet për një afat deri në 30 ditë.

177.2 Kuvendi mund ta përmbysë vendimin e Kabinetit me shpallë gjendjen e fatkeqësisë.

177.3 Gjendja e fatkeqësisë mund të zgjatet vetëm me pëlqimin e Kuvendit.

Neni 178. Kufizimi i të drejtave

178.1 Gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme nuk mund të kufizohen të drejtat e parashikuara nga nenet 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 25, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 39, 40, 43, 52, 57, 65, dhe 66, me përjashtim të paragrafëve 39.4, 52.3, 57.2(4), 66.1, dhe 66.3.

178.2 Gjatë gjendjes së fatkeqësisë mund të kufizohen:

- (1) paprekshmëria e banesës;
- (2) liria e lëvizjes;
- (3) e drejta e shpërblimit në rast shpronësimi; dhe

(4) e drejta për grevë.

178.3 Aktet për ndërmarrjen e masave të jashtëzakonshme duhet të cilësojnë të drejtat që kufizohen sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 179. Pushteti ligjvënës

179.1 Kur Kuvendi nuk mund të mblihet gjatë gjendjes së luftës, Prijetari, me këshillim të Kabinetit, ka të drejtë të nxjerrë akte që kanë fuqinë e ligjit.

179.2 Aktet e nxjerra sipas këtij neni humbin fuqinë nëse Kuvendi nuk i miraton në mbledhjen më të parë.

KREU X. SHQITJE TJERA

Nënkreu A. Çështje ekonomike

Neni 180. Rendi ekonomik

180.1 Rendi ekonomik mbështetet në lirinë dhe mundësitë e barabarta për sipërmarrësi të vyeshme.

180.2 Shteti kujdeset për mirëqenien e përgjithshme:

- (1) duke siguru mundësi të barabarta për veprimtari të vyeshme ekonomike;
- (2) duke nxitë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe punësimin e qytetarëve;
- (3) duke mbrojtë investuesit dhe pronën;
- (4) duke mbrojtë, sipas ligjit, konkurrencën e lirë;
- (5) duke mbrojtë konsumatorët dhe huamarrësit;
- (6) duke themelua organe të pavarura për rregullimin e tregut kur vetë tregu nuk është në gjendje ta mbrojtë interesin botor;
- (7) duke marrë masa me pengu shtrenjtimin afatgjatë të mallrave dhe shërbimeve; dhe
- (8) duke marrë masa me pengu përqendrimin e popullsisë dhe pasurisë në një pjesë të vendit.

180.3 Shteti mund të kushtëzojë zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare me respektimin e të drejtave themelore jashtë vendit.

Neni 181. Financat

181.1 Çdonjëri nën tagrin e Dardanisë ka detyrë t'i paguajë tatimet dhe detyrimet financiare të përcaktuara me ligj.

181.2 Shteti mbledh dhe shpenzon mjete pasurore sipas ligjit, haptazi, dhe sa më efektshëm.

181.3 Organet shtetërore japin llogari për shpenzimet e tyre. Huatë shtetërore rregullohen me ligj.

Neni 182. Të mirat e veçanta

182.1 Populli ka të drejtë të gëzojë burimet dhe pasuritë natyrore të vendit. Ato përfshijnë ujërat, hapësirën ajrore, pasuritë minerare, tokën, pyjet, botën bimore e shtazore, dhe tjera të mira të veçanta të përcaktuara me ligj.

182.2 Rregullohen me ligj kufizimet e të drejtave mbi të mirat e veçanta dhe kompensimi për kufizimet e tilla.

Neni 183. Privatizimi

183.1 Asnjë veprimtari shtetërore nuk mund të privatizohet, përveçse kur entiteti që rrjedh nga privatizimi shet prodhimet ose shërbimet e veta në një treg konkurrues dhe të përbërë kryesisht nga blerës privatë.

183.2 Shteti mund të rishtetëzojë çdo ish-veprimtari shtetërore që është privatizuar në kundërshtim me këtë nen. Për ta rishtetëzuar një veprimtari të tillë, shteti paguan si kompensim shumë më të madhe nga privatizimi i veprimtarisë *minus* shumë më të madhe entiteti i privatizuar dhe entitetet e ndërlidhura kanë fitu nga veprimtaria e privatizuar.

Nënkreu B. Çështje kombëtare

Neni 184. Logu Kombëtar

184.1 Logu Kombëtar është organ këshillues për çështjet që kanë të bëjnë me kombin shqiptar, përfshi bashkëpunimin mbarëkombëtar dhe mbrojtjen e interesave të shqiptarëve jashtë Dardanisë.

184.2 Logun Kombëtar e kryeson Prijetari, në bashkërendim me Kryeministrin.

Neni 185. Këshilli i Kombësive

185.1 Këshilli i Kombësive është organ që mbron pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e pjesëtarëve të kombësive në ligje, qeverisje, dhe punësim.

185.2 Këshillin e Kombësive e drejton Prijetari.

Nënkreu C. Pushteti vendor dhe ndarja tokësore

Neni 186. Përcaktimi

186.1 Qeverisja vendore mbrohet dhe rregullohet me ligj dhe mbështet në zgjedhje të lira e të drejtpërdrejta.

186.2 Nuk mund të ketë kurrfarë njësie sovrane përpos shtetit.

186.3 Njësitë e qeverisjes ose ndarjes tokësore nuk mund të themelohen:

- (1) në vija kombësish ose prirjesh politike a ideologjike; ose
- (2) brenda hapësirave tokësore të shkëputura, të shkapërderdhura, ose të lidhura mes vete përmes korridoreve.

Neni 187. Bashkitë

187.1 Bashkia është njësi themelore e ndarjes tokësore dhe qeverisjes vendore.

187.2 Bashkitë kanë tagër që, sipas ligjit:

- (1) të nxjerrin urdhëresa e të marrin vendime brenda fushëveprimit të tyre;
- (2) të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe me palë të treta brenda e jashtë shtetit; dhe
- (3) të mbledhin, caktojnë, e shpenzojnë të hyra dhe të marrin fonde nga qeveria qendrore.

Neni 188. Trevat

188.1 Treva është njësi e ndarjes tokësore, e rregulluar me ligj për qëllime të mbarështimit shtetëror.

188.2 Trualli i një treve ngërthen në tërësi një ose më shumë bashki.

Neni 189. Organet qendrore

- 189.1 Organi qendror që i dërgon bashkisë përgjegjësi të posaçme mbulon shpenzimet që rrjedhin prej asaj përgjegjësie.
- 189.2 Organet qendrore rishikojnë aktet që bashkitë nxjerrin brenda fushëveprimit të tyre vetëm për përputhje me ligj.
- 189.3 Organet qendrore drejtojnë të gjithë veprimtarinë e trevave.

Nënkreu Ç. Parime shtesë të qeverisjes

Neni 190. Orari i zgjedhjeve

- 190.1 Zgjedhjet për Prijetar dhe zgjedhjet vendore mbahen, për aq sa është e mundshme, të njëjtën ditë.
- 190.2 Zgjedhjet për Kuvend mbahen, për aq sa është e mundshme, të paktën një vit larg zgjedhjeve të rregullta për Prijetar dhe zgjedhjeve vendore.
- 190.3 Referendumi, për aq sa është e mundshme, mbahet të njëjtën ditë me zgjedhjet e parapara për atë vit.
- 190.4 Për ta zbatu këtë nen, Prijetari mund ta shkurtojë deri në një vit mandatin e vet, të ligjvënësve, ose organeve të qeverisjes vendore.

Neni 191. Ecuria zgjedhore

- 191.1 Vota e qytetarit mund t'i njehet vetëm kandidatit që zgjedh qytetari. Vota ose mandati i fituar nuk mund t'i njehen togut ose partisë politike në të cilën bën pjesë kandidati.
- 191.2 Çdo qytetar ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës me shqyrtu mbarëvajtjen e zgjedhjeve.

Neni 192. Formula e betimit

- 192.1 Prijetari, ligjvënësit, dhe anëtarët e Kabinetit bëjnë këtë betim:
«Betohem se do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve tjera të vendit, do të respektoj të drejtat themelore të secilit, do të mbroj pavarësinë e Dardanisë, dhe do t'i shërbej të mirës së përgjithshme dhe përparimit të popullit tonë».

- 192.2 Gjyqtarët bëjnë këtë betim: «Betoem se do t'i bindem Kushtetutës dhe ligjeve tjera të vendit, do të mbroj të drejtat themelore të secilit dhe sovranitetin popullor, dhe do t'i shërbej pa kusht drejtësisë dhe së mirës së përgjithshme».
- 192.3 Zyrtarët tjerë betohen, sipas formulës së caktuar me ligj, se do t'i binden Kushtetutës dhe ligjeve tjera të vendit dhe do ta kryejnë me besnikëri detyrën që pranojnë.

Neni 193. Rroga e zyrtarëve

- 193.1 Nuk mund t'i ulet rroga gjatë kohës sa shërben gjyqtarit, përndjekësit, ose zyrtarit të lartë të një organi të pavarur dhe jopolitik.
- 193.2 Rrogat e gjyqtarëve, përndjekësve, dhe zyrtarëve të lartë të organeve të pavarura rriten çdo vit në përputhje me shtrenjtimin e përgjithshëm të mallrave dhe shërbimeve.

Nënkreu D. Referendumi

Neni 194. Kërkesa dhe shpallja

- 194.1 Mund të mbahet referendum për ta miratu ose shfuqizu një ligj ose për çështje me rëndësi të posaçme.
- 194.2 50 mijë qytetarë, një e katërta e të gjithë ligjvënësve, ose Kryeministri mund ta kërkojnë referendumin.
- 194.3 Mbajtjen e referendumit e miraton Prijetari ose Kuvendi.

Neni 195. Rishikimi gjyqësor

- 195.1 Pasi të miratojë mbajtjen e referendumit, Prijetari ose Kuvendi njofton Gjykatën Kushtetutore për çështjen që do të shtrohen në referendum.
- 195.2 Brenda 60 ditëve vijuese, Gjykata Kushtetutore e parandalon referendumin nëse vlerëson se çështjet e shtruara nuk janë në pajtim me Kushtetutën; nëse jo, ia paraqet vlerësimin e vet Prijetarit.
- 195.3 Gjykata Kushtetutore nuk shqyrton nëse çështja e shtruar është e rëndësisë së posaçme.

Neni 196. Zhvillimi i referendumit

196.1 Ditën që merr vlerësimin e Gjykatës Kushtetutore ose brenda 14 ditëve vijuese, Prijetari thërret referendumin. Referendumi mbahet brenda një viti pas ditës që e thërret Prijetari.

196.2 Çështja e shtruar quhet e miratuar kur për të votojnë shumica e të gjithë qytetarëve me të drejtë vote.

Neni 197. Shpallja

197.1 Ligjin e miratuar me referendum e shpall Prijetari ditën që vërtetohet rezultati i referendumit ose brenda shtatë ditëve vijuese.

197.2 Nëse Prijetari nuk shpall ligjin, ligji vetëshpallet shtatë ditë pas ditës që vërtetohet rezultati i referendumit.

Neni 198. Kufizime

198.1 Nuk mund të shtrohen në referendum çështjet që kanë të bëjnë me:

- (1) tërësinë tokësore të Dardanisë;
- (2) kufizimin e të drejtave themelore;
- (3) buxhetin;
- (4) tatimet e detyrimet financiare të shtetit;
- (5) vendosjen ose heqjen e masave të jashtëzakonshme;
- (6) shpalljen e luftës ose bërjen e paqes; ose
- (7) faljen.

198.2 Referendumi për të njëjtën çështje mund të mbahet vetëm një herë brenda tri vjetëve.

Nënkreu Dh. Ndryshimi i Kushtetutës

Neni 199. Nisma dhe miratimi

199.1 Mund të parashtrojë ndryshimin e Kushtetutës kushdo që ka të drejtë t'i parashtrojë Kuvendit një ligj për shqyrtim dhe miratim.

199.2 Çdo ndryshim i Kushtetutës bëhet me ligj kushtetues, i cili përtërësohet në Kushtetutë me të hy në fuqi.

199.3 Ligjin kushtetues e miraton Kuvendi me dy të tretat e të gjithë ligjvënësve.

Neni 200. Rishikimi gjyqësor

200.1 Pasi ta miratojë ligjin kushtetues, Kuvendi ia paraqet atë Gjykatës Kushtetutore.

200.2 Brenda 30 ditëve vijuese, Gjykata Kushtetutore vlerëson nëse ligji pakëson të drejtat themelore ose sovranitetin e popullit dhe:

- (1) nëse vlerëson se po, e kthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend dhe cek arsyet pse po e kthen ligjin; ose
- (2) nëse vlerëson se jo, ia paraqet ligjin Prijetarit.

Neni 201. Rimiratimi

201.1 Nëse Gjykata Kushtetutore e kthen ligjin, Kuvendi mund ta rimiratojë, me pesë të shtatat e të gjithë ligjvënësve, ligjin të pandryshuar.

201.2 Pasi ta rimiratojë ligjin, Kuvendi ia paraqet atë Prijetarit.

Neni 202. Shpallja

202.1 Ditën që i paraqitet ligji kushtetues ose brenda shtatë ditëve vijuese, Prijetari shpall ligjin.

202.2 Nëse Prijetari nuk shpall ligjin, ligji vetëshpallet shtatë ditë pas ditës që i paraqitet Prijetarit.

Nënkreu E. Kalimtare dhe të fundit

Neni 203. Emërtimi i vendit

203.1 Emërtimet «Dardania», «Republika e Dardanisë», «Kosova», dhe «Republika e Kosovës» janë të barasvlershme për aq sa i referohen një shteti të pavarur.

Neni 204. Ligjshmëria

- 204.1 Shfuqizohet në tërësi Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar më 2008.
- 204.2 Ligjet tjera mbeten në fuqi për aq sa janë në pajtim me këtë Kushtetutë dhe nuk ndryshohen ose shfuqizohen.
- 204.3 Çështjet kalimtare rregullohet me ligj të veçantë për zbatimin e Kushtetutës. Ai ligj miratohet në të njëjtën mënyrë si Kushtetuta dhe nuk i nënshtrohet rishikimit gjyqësor.

Neni 205. Hyrja në fuqi

Kjo Kushtetutë hyn në fuqi ditën që e shpall Prijetari.